

**Hulumtim**  
KOHA fiton  
çmimin "Nikolla  
Mladenov"

Fq.3



**PROTESTË  
QYTETARE**

U kërkua  
drejtësi për  
Abdulfetah Alimin

Fq.5



Bursa e  
tregut  
presidencial  
**Forum**

Fq.12-15




# Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE XIII · Numri 3616 · e shtunë/e diel, 23-24 mars 2019

1°C | 21°C

15 DEN



KOHA për  
mozaik

Fq.12-15

## EDITORIAL

Në 20 vjetorin  
e fushatës  
ajrore të  
NATO-s



Më 24 mars 1999, Avianoja ishte bërë baza më e përfolur ushtarake e NATO-s, prej ku u nis karvani i gjatë i shpëtimit. Ulërime bishave karpaticane me fytyrë njeriu kishte prishur gjumin e fëmijëve të Kosovës, por avionët e NATO-s po sillnin ninulla nga ajri, kurse nga toka vinte morali i pandërprerë...

Fq.2

## RAJON


Gratë  
shqiptare kanë  
marrëdhëniet  
më të ten-  
sionuara me  
burrat në  
Europë

Fq.16

## FORUM

Traditat  
e huaja  
s'bëhen  
tonat

Fq.10



## TËGJITHË VRAPOJNË PAS ADMINISTRATËS

# PUNA IDEALE, PUNA E SHTETIT



Për dallim prej sektorit privat, i cili ka vështirësi të mëdha të gjejë kadro të nevojshëm për nevojat e punës, në shpalljet për punësimin në administratë vazhdojnë të paraqiten shumë më shumë të interesuar se sa ka vende pune në sektorin publik


Fq.6

## Përgjysmohet Karadaku

Likovë, 22 mars - Likova po zbrazet. Ashtu sikurse fshatrat tjerë të Karadakut, në Likovë tashmë mungojnë rreth 30 përqindëshi i të rinjve. Mungesa e infrastrukturës, e ardhmja e sigurt dhe papunësia në rritje çdo ditë e më shumë duket se po le shkretë këtë fshat me mijëra banorë. Edhe numri i nxënësve në shkollën fillore "Dituria" po bie dukshëm. Nëse pas liberalizimit të vizave më 2009, Likova ishte qendër e vë-

mendjes me ikjet masive, tashmë shpërngulja vazhdon në heshtje. Investime të mëdha nuk janë zhvilluar as 18 vjet pas luftës së vitit 2001, ndërsa uji i pijshëm mungon edhe pse mbi fshat gjenden dy pendar që furnizojnë me ujë madje Kumanovën me rrethinë. Shaban Veseli, kryetar i Bashkësisë Lokale në Likovë, thotë se problemi kryesor është ikja të rinjve nga gjendja e rëndë ekonomike...

Fq.9



## EDITORIAL

# NË 20 VJETORIN E FUSHATËS AJRORE TË NATO-S



Emin AZEMI

**Përkushtimi shqiptar kundrejt Amerikës është shndërruar tashmë në një doktrinë shpirtërore disadekatëshe dhe "ëndrra amerikane" për shqiptarët është modeli më i kapshëm i luftës për liri e pavarësi**

Më 24 mars 1999, Avianoja ishte bërë baza më e përfolur ushtarake e NATO-s, prej ku u nis karvani i gjatë i shpëtimit. Ulërima e bishave karpatiane me fytyrë njeriu kishte prishur gjumin e fëmijëve të Kosovës, por avionët e NATO-s po sillnin ninulla nga ajri, kurse nga toka vinte morali i pandërprerë diplomatik ndërkombëtar dhe marshi ushtarak i UÇK-së. Populli martir i Kosovës po e përjetonte mrekullinë e një kthese që po e fuste kohën në parametra të pakrahueshëm me historitë e vuajtjeve dhe golgotave individuale e kolektive.

Por në krejt këtë rrëfim ishte një protagonist që i dha kujtesës sonë konturat e pashlyera të mbamendjes. Ai ishte Presidenti amerikan, Bill Clinton, fryma dhe fjala e të cilit ato ditë marsi kombinohehin për të shqiptuar zëshëm apelin e njeriut që e kupton thirrjen e tjetrit kur e ka më së keqi.

Aksioni i NATO-s para 20 vjetëve e shndërroi letargjinë e mosveprimit kolektiv në kauzë sublimë humane. Kosova kishte vite që po vuante përmasat shqetësuese të politikës gjenocidale të Beogradit dhe për pasojë rezultoi në një rezistencë të armatosur të shqiptarëve.

Por, ajo që atëherë konsiderohej e pamundur, sot mësohet si histori. Për herë të parë në histori u takuan në një pikë solidariteti ndërkombëtar i udhëhequr nga SHBA dhe disa shtete evropiane, me aspiratën liridashëse të një populli.

"Është një rrugë në të cilën duhet të shkojë bota në shekullin 21. Mësimi është i njëjtë, fuqia e shembullit tuaj mbetet e njëjtë. Duhet të jeni shumë krenarë për atë që keni arritur dhe unë i thashë presidentit dhe kryeministrit se e keni bërë punën shumë më mirë se sa kanë menduar të tjerët. Keni konsoliduar institucionet demokratike, keni nxitur shtypin e lirë dhe shoqërinë civile. Edhe shumë vende të tjera do pasojnë pavarësinë tuaj, jeni pjesë e FMN-së dhe shumë shpejt do jeni edhe pjesë e NATO-s e

Këto fjalë i tha në Prishtinë Presidenti Clinton, me rastin e inaugurimit të një bulevardit me emrin e tij para disa viteve. Bill Clintoni erdhi sërisht në Prishtinë për t'ua përcjellë mesazhin shqiptarëve të Kosovës se Amerika vazhdon të jetë pranë e tyre, kurse shtatorja e ngritur për nder të tij, do të jetë një simbol që ua përkujton shqiptarëve njeriun që e ndryshoi rrjedhën e historisë.

Kosova dhe gjithë shqiptarët kanë arsye të jenë përkushtues ndaj Amerikës dhe nuk është vetëm rasti i fundit kur ky shtet i fuqishëm udhëhoqi aleancën perëndimore për të shpëtuar një popull të tërë nga shfarosja dhe gjenocidi. Përkushtimi shqiptar kundrejt Amerikës është shndërruar tashmë në një doktrinë shpirtërore disadekatëshe dhe "ëndrra amerikane" për shqiptarët është modeli më i kapshëm i luftës për liri e pavarësi. Mbase, jo rastësisht edhe Rilindësi ynë, Mjeda, në poemthin e tij "Liria" me mjeshtri dhe vizion kishte ditur ta skicojë tablon amerikane si një fushë ku të gjithë popujt e robëruar mund të gjejnë frymëzim për përpjekjet e tyre liridashëse.

## NDRYSHIMET KUFITARE JANË PJESA E DYTË E TEATRIT GJEOPOLITIK

"Dy dekada pas sulmeve ajrore të NATO-s dhe 24 vite pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Dejtonit, ky kurs i ngjarjeve nuk ka gjasa të përsëritet në shkallë të gjerë. Meqenëse më shumë se gjysma e territoreve të banuara me shqiptarë vazhdojnë të qeverisen nga shtete të krijuara pas vitit 1912 dhe 1945-ës, do të ishte e vështirë që të dyja shtetet me popullsi më të madhe në rajon të bien dakord për një hartë të re me përmasa të ndryshimeve të mëdha të territorit.

Për nga raporti i Fuqive të Mëdha, ekziston një realitet i rëndë historik i cili bazohet në shqetësimet e Gjermanisë për kufijtë e rinj dhe tani Perëndimi duhet të shqetësohet më shumë se ndryshimet kufitare janë pjesa e dytë e teatrit gjeopolitik të kufijve në Ballkan", ka shkruar një status në Facebook, analisti Selim Ibraimi.

## PERVERSITET PUBLIK!

"Gjëja më pa vlerë që kam vënë re këto ditët e fundit është sarkazma e madhe, në rrjet, por jo vetëm, me Bashën dhe Ramën që ishin fotografuar nga "pasagjeri dixhital" duke fjetur në avion. Bashën e akuzuan se ia fut gjumit në qiell, ndërsa në tokë opozita proteston. Ndërsa Ramës ia bënë analizat dhe zbuluan se gjumi kishte ardhur si pasojë e overdozës.

Më falni, kush ka patur rastin të udhëtojë (fluturojë), çfarë bëhet tjetër në avion? Ose lexohet, ose bëhet muhabet kur fqinjën e njeh, ose flihet, kur të vjen gjumë. Madje të gjithë përpiqen të flenë, edhe pse jo të gjithë ia dalin. Në avion nuk protestohet, nuk mbahen fjalime, nuk bëhet vrap, nuk bëhen mbledhje, nuk këndohet. Tjetra, edhe më e shëmtuar, është të bërit lajm duke fyer dikë. Dhe ky është Dashamir Shehi. Është një nga politikanët më realistë, më të ndershëm, më me këmbë në tokë, më i drejtëpërdrejtë. Të fyesh Dash Shehin, që ka patur poste të larta qeveritare dhe jeton modestisht, është fyerje për ndershmërinë njerëzore.

Dhe përse e fyejnë? E fyejnë duke i thënë se pi raki me shokët? Edhe unë e kam pas pirë, dhe e shijoj mrekullisht edhe bisedën edhe shoqërinë. Edhe? Po Nanon që e lavdëronin, se pinte një shishe Wisky, e shkoi në mbledhje të qeverisë pa iu dridhur këmbët. Të fyesh Dash Shehin pse e jeton jetën ashtu siç i pëlqen atij, është njësoj si ti thuash një ish ministri: Shiko çfarë burri model. Ka tre hidrocentrale, dy inceneratorë, dy landfille, nja dy koncensione dhe ca miliona Euro për pare xhepi. Po si nuk e shikon të pijë një gotë more, po fare. Ka lezet!", ka shkruar një status në Facebook, gazetari nga Tirana, Mentor Kikia.

## MEDIA Citate

### KANDIQ: DËNIMI PËR KARAXHIQIN – I MERITUAR



Radovan Karaxhiq, dikur ka vendosur për jetët e mijëra njerëzve, tani do të jetë i burgosur i përjetshëm. Gjykata e Hagës ka shpallur fajtor ish-presidentin e serbëve të Bosnjës dhe autorin e masakrës së Srebrenicës në një verdikt të pakthyeshem.

Këtu nuk është përmendur fajësia e shtetit serb, por ata që kanë luftuar për zbardhjen e krimeve në Beograd, e kanë ndjekur me vëmendje gjykimin. Gruaja që ka grumbulluar çdo faktet në grimca, Natasha Kandiq, thotë se është lehtësuese dhe dënimi i merituar.

"Këto vendime do të duhej të ndikojnë tek politikanët e sotëm që ta kuptojnë se sjelljet si të Karaxhiq dhe Mlladiq nuk janë të kushtueshme vetëm për viktimat, por të mos përsëritet një gjë e tillë dhe të harrohet nacionalizmi." –tha Natasha Kandiq, Fondi për të Drejtën Humanitare.

Radovan Karaxhiq kishte kryer shtetërrëthimin e Sarajevës dhe është konsideruar fajtor për Srebrenicën, ku u ekzekutuan mbi tetë mijë viktime myslimane. I kishte ikur drejtësisë për gati çerek shekulli pavarësisht se për lirinë e tij ishin ofruar miliona euro shpërblim. Në kërkim të tij pak gjurmë kishin ngelur

Dr Dragan Dabiq, ishte i respektuar tek besimtarët e mjekësisë alternative. Nën mjekrën e bardhë të mjekut të dashur, fshihej autori i terrorit, i cili u arrestua në një autobus. Në Serbi, Kandiq, thotë se ka ngelur edhe shumë punë për tu bërë për mos mohimin e gjenocidit në Bosnje. Por, verdikti është i rëndësishëm si dëshmi për të ardhmen.

"Kjo natyrisht do të jetë pjesë e historisë. Ky njeri është i ndarë nga realiteti pasi kur sheh veprat e tij mendohesh se si ka mundësi që ky njeri ka shëruar njerëz dhe ka qenë psikiatër. Një person i rëndë dhe që ka menduar se kjo kurrë nuk do t'i ndodh. Kjo është drejtësia e pritur." vlerëson Natasha Kandiq, Fondi për të Drejtën Humanitare Karaxhiq, ishte dënuar me 40 vjet në shkallën e parë, kurse tani në bazë të rregullave të gjykatës së Hagës do të ketë vetëm mundësi të zgjedh shtetin se ku do të vuaj dënimin e përjetshëm, por kjo nuk do të jetë vendlindja.

(DANAS, 22 mars)



IMM NDAU TRE ÇMIMET TRADICIONALE PËR GAZETARI HULUMTUESE

# KOHA FITON ÇMIMIN "NIKOLLA MLLADENOV"

Seria e shkrimeve lidhur me keqpërdorimet e Ministrisë së Kulturës në miratimin e projekteve të Programit 2018 për kulturë ka fituar çmimin e dytë, ndërsa është vlerësuar si storja që përfundoi deri në largimin e ministrit të Kulturës



Shkup, 22 mars - Çmimi për gazetari hulumtuese "Nikolla Mlladenov" që tradicionalisht ndahet nga Instituti i Mediave të Maqedonisë (IMM) sivjet i është ndarë gazetares së gazetës KOHA, Evis Halili Memedaliu. Seria e shkrimeve lidhur me keqpërdorimet e Ministrisë së Kulturës në miratimin e projekteve të Programit 2018 për kulturë ka fituar çmimin e dytë, ndërsa është vlerësuar si storja që përfundoi deri në largimin e ministrit të Kulturës. "Përmes konsulti-

mit me burime të shumta dhe përpunimin profesional të disa dokumenteve, autorja Evis Halili paraqiti malverzimet serioze brenda Programit nacional për kulturës, siç ishte përbërja jokompetente e komisioneve dhe shpërndarja e fondeve të mëdha buxhetore për shoqatat dhe personat të afërt me

përfaqësues të Ministrisë kulturore, tha drejtoresha e IMM-së, Biljana Petkovska..

Çmimin e parë e mori storja për deponinë ilegale me helme të rrezikshme për shëndetin e qytetarëve në oborrin të fabrikës "Ohis" në Shkup, të realizuar nga gazetarja Slavica Filipova në emisionin

"360 shkallë" të Alsat-M, ndërsa vendi i tretë i takoi gazetares Vesna Kolovska me storjen me borxhin e komunave në vend. U ndanë edhe tri mirënjohje për storje të ndryshme që kanë të bëjnë me shëndetin, ekologjinë dhe sigurinë e qytetarëve. "Falënderoj IMM që për herë të dytë më ndan çmim si ga-

zetare e gazetës KOHA, këtë herë është një nder i veçantë që çmimi mban emrin Nikolla Mlladenov. Kultura dhe arti duhet të jenë të shenjta për një shoqëri, siç shihet nga këto artefakte nga antikiteti sesa të rëndësishme janë për ne dhe si duhet të kujdesemi dhe t'i kultivojmë. Sepse, siç thotë një krijues i njohur arti: "Është gënjeshtër për të zbuluar të vërtetën", tha Evis Halili, ndërsa falënderoi gjithë kolegët e gazetës KOHA që bashkërisht kishin hulumtuar në keqpërdorimet e Programit nacional për kulturë 2018.

Ndryshe, në konkursin e sivjetmë, siç informoi Komisioni për ndarjen e çmimeve, ishin paraqitur 30 autorë me 45 storje, ndërsa ishin përpunuar në 131 tekste-video kronika, të publikuara në portale interneti, televizione, gazeta ditore dhe në javore. Çmimi për storjen më të mirë hulumtuese tradicionalisht ndahet për të tetëmbëdhjetën herë, si pjesë e angazhimeve të IMM për zhvillimin e gazetarisë profesioniste dhe të vlerave demokratike në vend. (D.J)

Publicitet



ПОЧИТУВАЈ, НЕ МРАЗИ!  
RESPEKTO, MOS URRE!  
SAYGI GÖSTER, NEFRET ETME!  
RESPECT, DON'T HATE!



“

Gjuha e urrejtjes vret më shumë se armët!  
Jo, gjuhës së urrejtjes!

**Refet Abazi**  
Aktor

Kampanyata e inicirana i sprovodena od AŽNPOM | Fashata e iniciruar dhe realizuar nga AMMSHM | The campaign is initiated and implemented by APNPM

СЛОБОДЕН ПЕЧАТ. **вечер** **ПОРТА** **Капитал** **M** **ТАЖИ** **ZAMAN** **СРБИЈА** **Београд**

**Кoha** **НЕЗАВИСЕН** **ДОЈАК** **ЗЕНИТ ШЕНЈА** **M** **МАКЕДОНИЈА** **СЛОБОДЕН ПЕЧАТ** **Београд**

## Maqedonia e Veriut të përmbushë parakushtet

Athinë, 22 mars - Greqia e mbështet perspektivën evropiane të Maqedonisë së Veriut, por nevojitet respektim i plotë i të drejtës ndërkombëtare dhe implementim të drejtë të Marrëveshjes së Prespës, në të kundërtën do të bllokohet rruqa e saj evropiane, thotë presidenti Prokopis Pavlopulos në urimin drejtuar grekëve në diasporë me rastin e festës kombëtare 25 mars, lajmëroi korrespondentja e MIA-s nga Athina. Në urimin me shkrim, Pavlopulos përveç për rëndësinë e festës, i përmend edhe të a.q. çështjet kombëtare greke, marrëdhëniet e Greqisë me Turqinë, Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut, si dhe çështjen qipriote. "Sa i përket me Republikën e Maqedonisë së Veriut, ne e mbështesim perspektivën e saj evropiane. Por, parakusht për këtë perspektivë, nga ana e saj është respektimi i plotë dhe i sinqertë të legjislacionit evropian, me këtë edhe e drejta ndërkombëtare në tërësi, ndërsa para së gjithash Marrëveshja e Prespës, që duhet të interpretohet dhe të implementohet, sipas përmbajtjes dhe frymës së saj, në mënyrë që na le asnjë gjurmë të irredentizmit. Sipas kësaj, secila taktikë e kundërt, nënkuptohet, se do ta bllokojë progresin integruar evropian të Republikës së Maqedonisë", shkruan Pavlopulos në urimin, transmeton MIA. Presidenti grek thotë se "Greqia është faktor i paqes dhe të sigurisë në Ballkan dhe në rajonin me të gjerë të Mesdheut Juglindor dhe plotësisht dhe praktikisht i respekton të drejtën evropiane dhe ndërkombëtare" dhe synon drejt miqësisë dhe bashkëpunimit me të gjithë fqinjët.

Anëtari i KSHZ-së, Boris Kondarko u bëri thirrje kandidatëve t'i përmbahen nenit 68 të Kodit zgjedhor, në të cilin hollësisht është definuar se çka nënkuptohet me fushatë, së cilës ata duhet t'i përmbahen deri në fillimin e saj zyrtar, më 1 prill

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 22 mars - Kandidati i opozitës shqiptare për zgjedhjet e ardhshme presidenciale, Blerim Reka do të jetë i pari në fletëvotim, e dyta është kandidatja e VMRO-DPMNE-së dhe koalicionit, Gordana Siljanovska-Davitkova, ndërkaq i treti është kandidati i LSDM-së dhe koalicionit, Stevo Pendarovski.

Në Komisionin shtetëror zgjedhor dje u hedh shorti për renditjen e kandidatëve për president në fletëvotim. Numrat i tërhoqën përfaqësuesit e shtabeve zgjedhore, të cilët gjithashtu do të nënshkruajnë Kodin për sjellje korrekte në zgjedhjet e ardhshme me qëllim që të ketë garë korrekte mes të gjithë pjesëmarrësve. Anëtari i KSHZ-së, Boris Kondarko u bëri thirrje kandidatëve t'i përmbahen nenit 68 të Kodit zgjedhor, në të cilin hollësisht është definuar se çka nënkuptohet me fushatë, së cilës ata duhet t'i përmbahen deri në fillimin e saj zyrtar, më 1 prill.

Theksoi se secili me shembull vetanak mund të kontribuojë për zgjedhje të suksesshme, por edhe për pasqyrë pozitive të procesit zgjedhor. "Pasqyra e përgjithshme për procesin zgjedhor dhe për shtetin tonë varet nga ajo se si do të mbahen këto zgjedhje, prandaj u bëjmë thirrje të gjithëve, por para së gjithash kandidatëve për president në këtë periudhë para fillimit të fushatës por edhe gjatë fushatës, rreptësisht të përmbahen, të jenë përgjegjës dhe të sillen se-

HIDHET SHORTI PËR RENDITJEN E KANDIDATËVE

# REKA I PARI, SILJANOVSKA E DYTA, PENDAROVSKI I TRETI



## EDHE NJË SHQIPTAR GARON PËR KOMUNËN E OHRIT

Të hënën ndërkohë do të hidhet shorti për renditjen e kandidatëve për kryetar të komunave Ohër, Novo Sellë dhe Dibër. Në ndërkohë, pesë kandidatë kanë parashtruar kandidaturën për funksionin kryetar komune në Ohër në zgjedhjet e parakohshme që do të mbahen më 21 prill. Ato janë Kiril Trendafilov - Nançe nga partia e Unionit - Demokratik Qytetar,

Mitre Milloshoski nga VMRO-DPMNE, Konstatin Georgieski nga LSDM-ja, Stevçe Stevoski si kandidat i partisë politike Demokratët dhe Xhemal Mena nga Lëvizja BESA. Zgjedhjet për funksionin kryetar komune u shpallën për shkak vdekjes të papritur të kryetarit të komunës së Ohrit Jovan Stojanoski, i cili vdiq më 15 dhjetor të vitit të kaluar. (D.J)

riozisht ndaj të gjitha rregullave të përshkruara në Kodin zgjedhor, që kanë të bëjnë me fillimin e parakohshëm të fushatës", tha Kondarko, ndërsa bëri thirrje dhe kërkoi fushatë korrekte, të pastër dhe pozitive evropiane.

"Sepse, ajo është në interes të të gjithëve, para së gjithash kandidatëve, integritetit të tyre, në interes të partive politike, në interes të KSHZ-së, dhe në interes të mbarë shtetit. Nuk ka nevojë që për shkak të disa veprimeve dhe deklaratave të pamenduara ne si KSHZ të vihe-

mi në rolin e gjykatës dhe të vendosim rreth ankesave të caktuara", nënvizoi Kondarko. Kryetari i KSHZ-së, Oliver Derkovski përkujtoi se dje Komisioni ka sjellë konkludim për konfirmimin e kandidatëve të cilët do të marrin pjesë në zgjedhje, pasi që ishte konfirmuar rregullshmëria e kandidaturave të tyre dhe theksoi se kjo do të thotë se ata edhe zyrtarisht janë në garë zgjedhore. Megjithëse rrethi i parë i zgjedhjeve presidenciale në RMV do të mbahet më 21 prill, procesi votues për personat

e sëmure dhe me nevoja të veçanta do të jetë më 20 prill. Më 20 prill do të votojnë edhe anëtarët e KSHZ-së. Rrethi i dytë zgjedhor do të mbahet 5 maj, ndërsa fushata për rrethin e dytë mbaron më 3 maj. Fitues i zgjedhjeve është njëri nga dy kandidatët i cili ka siguruar më së shumti vota, por me kusht që të arrihet censusi, votimi i më shumë se 40 për qind i qytetarëve të regjistruar në Listën Zgjedhore. Nëse edhe në rrethin e dytë nuk zgjidhet presidenti, përsëritet tërë procesi zgjedhor.

## KONFIRMOHET, CIPRASI NË FILLIM TË PRILLIT VIZITON SHKUPIN



Athinë, 22 mars - Si duket që vizita e kryeministrit grek Aleksis Cipras në Shkup planifikohet në javën e

parë të prillit, ka thënë ministri për Punë të Jashtme i Greqisë Jorgos Katrugallos në intervistën për ra-

dion greke "Njuz247", pa vërtetuar pastaj datën 2 prill që intensivisht përmendet gjatë periudhës së kaluar, bën të ditur korrespondentja e MIA-s në Athinë. I pyetur për spekulimet në Greqi për këmbim të përmendoreve, shefi i diplomacisë greke ka thënë se disa, në mënyrë komunikuese, "tentojnë të menaxhojnë me orvatjet të cilat bëhen që të ndërtohen marrëdhënie të mira".

"Tentojmë të gjejmë mënyra me njerëz të cilëve u thoshim mirëdita, bashkë të planifikojmë promovimin e interesave të përbashkëta dhe stabilizim të rajonit.

Mendojmë për mënyra që popujve tanë do t'u tregojnë se klima me të vërtetë është përmirësuar. Këto lëvizje do t'i bëjmë me kujdes", ka thënë Katrugallos. Në intervistë, shefi i diplomacisë greke ka folur edhe për reagimet e Marrëveshjes së Prespës, veçmas në pjesën veriore të Greqisë dhe ka thënë se "ekziston reagim emocional" por me vijimin e kohës të gjithë do t'i kuptojnë përfitimet, veçmas ato ekonomike nga zgjidhja mes dy vendeve.

"Kemi krenari të lënduar kombëtare nga koha e memorandumit dhe lehtësisht një marrë-

veshje pozitive mund të lexohet përmes syzeve të ndryshimit. Mendimi im personal është se siç kalon koha, ashtu siç Greqia Veriore do të fillojë t'i kuptojë, në fazën e parë përfitimet ekonomike që do t'i ketë Greqia Veriore nga marrëveshja dhe në realitet do të jetë qendra, zemra e ekonomisë të një hapësire të bashkuar ballkanike e cila do të ketë 50 milionë, pastaj do të mund qetë t'i shqyrtojnë përfitimet e rëndësishme nga Marrëveshja e Prespës për vendit tonë", ka thënë Katrugallos për Njuz247", transmeton MIA.



PROTESTË QYTETARE

# U KËRKUA DREJTËSI PËR ABDULFETAH ALIMIN

Organizatorët e protestës paralajmëruan se tubimi i ditës së premte ishte vetëm fillimi dhe se nuk do të ndalen deri në lirin e Fetah Alimit

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 22 mars - Për të satën e herë me radhë, nën moton "Pa drejtësi, nuk ka qetësi", para Gjykatës Penale në Shkupit, u zhvillua protestë qytetare. Kësaj radhe protesta ishte organizuar nga familjarët dhe të afërmit e Abdulfetah Alimit, i cili javë më parë u dënua me 7 vit burg për ngjarjet e 27 prillit. Në këtë protestë morën pjesë mbi 300 protestues. Duke marshuar nga Sheshi Skënderbeu e deri para Gjykatës Penale të Shkupit, protestuesit kërkuan lirin e sa më të shpejtë të Fetah Alimit, ish-sigurimi i Parlamentit që e shpëtoi deputetin Ziadin Sela, mbrëmjen e 27 prillit.

Maide Jashari, në emër të Këshillit organizativ të protestës për lirin e Fetah Alimit, para protestuesve dhe mediave u shpreh se gjithkund nëpër botë personat që ndihmojnë dhe shpëtojnë jeta njerëzish shpërblehen, ndërsa vetëm në shtetin tonë ata dënohen dhe persekutohen.

"Pikërisht në momentin kur ne pritshim që Fetah Alimi të shpërblehet dhe dekorohet për veprimin e tij heroik me 27 prill, duke ju dalë në mbrojtje deputetëve të Parlamentit, ai u dënua dhe trajtua njëjtë si dhunuesit që deshën të



vrasin deputetë. Kjo është tepër dëshpëruese dhe paradoksale për faktin se u amnistuan fajtorët e vërtetë", tha Jashari.

Akti i Alimit, tashmë të dënua me 7 vite burg nga Gjykata e shkalës së parë, për organizatorët e protestës në asnjë moment nuk mund të minimizohet si i paqenë, për shkak se ai shpëtoi jetë njerëzish. Në mesin e shumë porosive që u shpallën para Gjykatës, protestuesin vazhdimisht brohorisnin se duan drejtësi dhe jo mëshirë, respektivisht ata u shprehën se drejtësia nuk është pazar.

Nurie Alimi, bashkëshortja e Fetah Alimit, mes lotësh, duke folur para gazetarëve dhe protestuesve apeloj deri te organet përkatëse, si ato gjyqësore dhe politike, që atyre si familje mos t'ua shkatërojnë harmoninë dhe ardhmërinë.

"I apeloj kryeministrit Zoran Zaev që të zbardh padrejtësinë ndaj Fetah Alimit. Ai është i drejtë. Dënimi ndaj tij është i padrejtë.

Mos na e shkatëroni familjen pa nevojë. I lutem kryeministrit që të përfshihet në rast. Vetëm drejtësi kërkohet", tha Nuri Alimi.

Para të pranishmëve në Shkup, foli edhe ish-deputeti Hysni Shaqiri. Dënimin ndaj Fetah Alimit, e cilësoi si një proces të montuar politik. Në fjalimin e tij, mes tjerash ai shtoi se Fetahu nuk i ka dhënë çelësat, por ia kanë marrë.

"Ai i cili ia mori çelësat sot është i amnistuar. Ndërsa, Fetahu, në vend të avancimit për shpëtimin e deputeti Ziadin Sela, ashtu siç bëhet në vendet demokratike, u dënua. Deri sa nuk pastrohen këto veprime që vendit gjithnjë i sjellin krizë, këtu nuk do të ketë qetësi dhe rahat. Shqiptarët janë shtetas të këtij vendi. Ne kemi bërë përpjekje dhe luftë për ti gëzuar të drejtat e barabarta. Kemi bërë gjithçka që ligji mos të zbatohet në mënyrë selektive. Ne kemi pasur shumë raste të montuar. Po ashtu kanë ndodhur tragjedi shumë të mëdha nga situata të

përgatitura nga struktura të caktuar të shërbimeve sekrete anti-shqiptare. Duke filluar nga rasti i 'Kumanovës' apo ai i 'Alfave'. Nga të gjitha këto procese të montuara mos të mendojë dikush se humbin vetëm shqiptarët. Nga kjo tragjedi të shqiptarëve do të fundosin të gjitha ata që i provojnë dhe u krijojnë rrethana të paqëndrueshme për jetë", tha Shaqiri.

Organizatorët e protestës paralajmëruan se tubimi i ditës së premte ishte vetëm fillimi dhe se nuk do të ndalen deri në lirin e Fetah Alimit.

Ndryshe, ish-pjesëtari i sigurimit të Parlamentit, Alimi, i akuzuar nga Prokuroria për krim të organizuar u dënua për veprën penale "terrorizëm". Gjatë procesit gjyqësor e vetmja dëshmi që u publikua kundër Alimit, ishte video-materiali ku ai shihet se si ia jep çelësat e dyerve, Goran Gjoshevski-Levit, shef i sigurimit të kryeparlamentarit të atëhershëm, Trajko Veljanovski.

## KRONIKË

### Arrestohet një shtetas i Shqipërisë

Në orët e para të mëngjesit të ditës së premte është arrestuar 31 vjeçari K.K nga Shqipëria. Sipas policisë, ai ka qëndruar në territorin e Maqedonisë së Veriut pa leje adekuate. Pas arrestimit, i njëjti është mbajtur për procedurë të mëtejshme në Stacionin policor në Tetovë. Ky është arrestimi i dytë brenda 48 orëve që ndodh në Tetovë i shtetasve të Shqipërisë për shkak të qëndrimit të tyre pa leje adekuate.

### Arrestohet 57 vjeçari nga fshati Orashë

Policia e Tetovës, të enjten mes orës 16 dhe 17, ka kryer kontroll në shtëpinë dhe hapësirat ndihmëse të 57 vjeçarit I.A nga fshati Orashë e Epërme. Gjatë kontrollit, me urdhër të gjykatës, është gjetur marihuanë, me ç'rast është arrestuar dhe mbajtur në stacionin policor në Tetovë për procedurë të mëtejshme.

### Tetovari shkakton aksident, dëmton dy makina të parkuara

Të enjten mbrëma rreth orës 22 e 25 minuta, në rrugën "Ivo Lolla Ribar" në Tetovë, veturë e markës, Fiat Bravo, me targa të Tetovës, të cilën pa leje për vozitje e ka drejtuar 28 vjeçari M.B nga Tetova, ka humbur kontrollin dhe ka goditur dy vetura të parkuara edhe atë, një Golf dhe një Pezho. Po ashtu ka goditur edhe një pjesë të një objekti hotelierik. Nga ky aksident, lëndime ka marrë një 17 vjeçar, bashkudhëtarë me tetovarin, i cili është dërguar në Spitalin klinik të Tetovës për ndihmë mjekësore. (U.H)

## Shpenzimet e larta do t'i shtrenjojnë banesat

Shkup, 22 mars - Çmime më të larta të banesave në periudhën e ardhshme për shkak të rritjes së vazhdueshme të shpenzimeve për materiale ndërtimore dhe për të punësuarit, pret Oda Ndërtimore pranë Lidhjes së Odave Ekonomike. "Nëse dëshirojmë, ndërsa duhet të ndërtojmë banesa cilësore, është fakt se çmimi do të rritet, ndërsa sa do të jetë përqindja do të tregojë tregu dhe ky është realiteti, tha sot

në konferencën për shtyp Ivica Jaqimovski, kryetari i Odës Ndërtimore pranë LOE-së.

Siç potencoi, rritja e vazhdueshme e shpenzimeve për materiale ndërtimore dhe për të punësuarit në kompanitë ndërtimore, e dikton edhe rritjen e çmimit të banesave cilësore dhe në periudhën e ardhshme nuk do të mundet të ofrohet ndërtim cilësor me çmime më të ulëta. Të dhënat e fundit të Entit

Shtetëror të Statistikës, theksoi Jaqimovski, e konfirmojnë gjendjen dhe tregojnë se shpenzimet në ndërtimtarit për objekte të reja për banim individual në tremujorin e katërt të vitit të kaluar në krahasim me tremujorin e njëjtë nga viti 2017 janë më të larta për 5,9 për qind, shpenzimet për materiale janë rritur për 3,2 për qind, ndërsa për të punësuarit për 13 për qind. Rritja e shpenzimeve është rezultat i rritjes

së çmimit të energjisë dhe transportit dhe për materialet të cilat importohen dhe për ata nga prodhimitaria shtëpiake. "Nëse në vitet e kaluara, duke përjashtuar dy të fundit në pjesën e ndërtimit të lartë kishte vazhdimësi dhe stabilitet, në kushtet e tanishme të pasigurisë juridike investitorët nuk kanë mundësi që të investojnë. Ajo që mund të presim në periudhën e ardhshme është se nuk do të mun-

det të ofrohet ndërtim cilësor me çmime më të ulëta, sepse rritja e shpenzimeve e dikton edhe rritjen e çmimit të banesave cilësore, tha presidenti i Odës Ekonomike.

Siç tregoi, shfrytëzimi i materialeve cilësore, me zbatim të trendeve më të reja për ndërtim të banesave më efikase energjetike me cilësi të lartë, kushtojnë më shumë, por në afat të gjatë nënkuptojnë kursim të dyfishtë. (Q.A)

Për dallim prej sektorit privat, i cili ka vështirësi të mëdha të gjejë kuadro të nevojshëm për nevojat e punës, në shpalljet për punësimin në administratë vazhdojnë të paraqiten shumë më shumë të interesuar se sa ka vende pune në sektorin publik

Koha Fisnik PASHOLLI

*Shkup, 21 mars* - Për dallim prej sektorit privat, i cili ka vështirësi të mëdha të gjejë kuadro të nevojshëm për nevojat e punës, në shpalljet për punësimin në administratë e shtetit paraqiten shumë më shumë të interesuar se sa ka vende pune në sektorin publik. Këtë e mbështesin edhe të dhënat të statistikës zyrtare për muajin janar të këtij viti e që tregojnë se pagat në industrinë përpunuese në shtet janë 20.128 denarë që është për 8000 denarë më pak në raport me pagat mesatare (28.126 denarë) në administratën publike në muajin janar të 2019-ës.

Njëherësh, edhe hulumtimet e para disa viteve kanë treguar se gati gjysma apo 42 për qind e studentëve të diplomuar për punë ideale e vlerësojnë punën e shtetit. Vetëm 10 për qind prej tyre dëshirojnë të punojnë në ndonjë kompani private, ndërsa vetëm një e katërta kishin preferuar të hapin biznes vetanak. "Në administratën

TË GJITHË VRAPOJNË PAS ADMINISTRATËS

# PUNA IDEALE, PUNA E SHTETIT



publike dihet se punësuarit nuk duhet të kenë produktivitet të madh dhe të mos angazhohen tepër në vendin e punës. Përkundër kësaj, kemi shembuj që përparohet pa investuar shumë në veten, andaj edhe të rinjtë vlerësojnë se pa ndonjë mund të madh mund të avancohen apo edhe të fitojnë pagë të njëjtë apo edhe më të lartë se tek privati", thotë konsulentja ekonomike Biljana Markoviq. Nga ana tjetër, vlerësohet se punësimi në sektorin publik në Maqedoninë e Veriut e rehaton punëtorin deri në pension. Këtë e dëshmojnë edhe të dhënat për rritjen e madhe të numrit të të punësuarve në kompani në pronësi të komunave apo të shtetit. Në 129 ndërmarrje publike në tërë

Maqedoninë janë të punësuar mbi 17.872 persona, tregon Regjistri i të punësuarve në sektorin publik. Kjo paraqet dyfishin e të punësuarve në këto kompani në raport me dhjetë vite më parë. Sipas të dhënave të Avokatit të Popullit, në vitin 2007, në ndërmarrjet publike kanë qenë të punësuar 8299 persona, që do të thotë dyfishimin e tyre në periudhën 2007-2017.

"Një kohë të gjatë tek ne, qytetarët janë të mendimit se me punësimin në shtet apo në sektorin publik do të kenë një stabilitet më të madh për një periudhë më të gjatë kohore, si dhe më shumë do t'ju respektohen të drejtat e tyre si punëtorë. Përkundër asaj se të njëjtat respektohen edhe në numrin më të madh të firmave private",

thonë nga Instituti financiar "Faj-nens Think". Ndryshe, qytetarët e Maqedonisë dhe Serbisë renditen menjëherë pas Shqipërisë dhe Turqisë për përqindjen më të lartë të të anketuarve që janë përgjigjur që ka gjasa që ta humbasin vendin e punës në gjashtë muajt e ardhshëm. Pyetja e Anketës për Cilësi të Jetës, të kryer në vitin 2018, nga ana e Komisioni Evropian se "Sa gjasa ka që të humbisni vendin e punës në gjashtë muajt e ardhshëm?", ka marrë përqindjet më të larta në Shqipëri me 28 për qind, në Turqi me 23 për qind, e pasuar me nga 17 për qind në Maqedoni dhe Greqi.

Në ndërkohë, ndër vendet anëtare të Bashkimit Evropian, Gjermania si shtet ku sindikata janë

shumë të forta dhe Malta, janë dy shtetet ku përqindja e të anketuarve të cilat kanë thënë se kanë gjasa të humbasin vendin e punës është më e ulëta, vetëm 5 për qind. Ndërsa ndër vendet anëtare të BE-së që kanë përqindjen më të lartë të njerëzve që kanë frikë se në gjashtë muajt e ardhshëm mund të humbasin vendin e punës është Greqia me 17 për qind. Më pas renditet Lituania dhe Qipro me 16 për qind, si dhe Estonia me Letoninë me nga 15 për qind. Përqindjen më të ulët në rajon e ka Mali i Zi, ku vetëm 14 për qind e të anketuarve janë shprehur se ka gjasa se mund ta humbasin vendin e punës.

Ndryshe, në të ardhmen - sfida për shoqërinë paraqet edhe zgjidhja e problemeve me sistemin e arsimit të mesëm dhe atij të mesëm profesional, pasi Maqedonisë i mungon praktika më e madhe e që do të ofrojë kuadër të gatshëm që menjëherë të inkuadrohet në procesin e punës. Problem tjetër është edhe fakti se sistemi arsimor në Maqedoni fare pak prodhon kuadër të trajnuar për kërkesat e biznesit dhe industrisë në shtet. Bile, në nivel shteti, janë shumë të dobëta lidhjet midis nevojave të biznesit, tregut të punës dhe arsimit profesional të mesëm. Shpesh edhe profilet arsimore nuk i përgjigjen nevojës së kompanive private, ndërsa nxënësve ju mungon edhe praktika profesionale përkundër njohurive teorike.

## Shkupjanë pinë ujë të pastër

*Shkup, 22 mars* - Banorët e Shkupit pinë ujë të pastër dhe të shëndetshëm dhe nuk duhet të brengosen nëse ka mjaftueshëm, me çfarë cilësie dhe në cilën pjesë të ditës. Ujë ka mjaftueshëm. Këtë sot e theksoi kryetari i Shkupit, Petre Shilegov, drejtori i "NP Ujësjellësi dhe Kanalizimi", Dushko Veskovski dhe Zoran Bozhinovski drejtor i Qendrës për kontroll sanitar në kuadër të kësaj ndërmarrje publike në shënimin e 22 Marsit - Ditës Botërore të Ujit. NP "Ujësjellësi dhe kanalizimi" e garanton cilësinë e ujit të pijshëm për qytetarët e Qytetit të Shkupit dhe e kemi njërin prej burimeve më të mira në Evropë e ai është Burimi Rahçe 1 dhe Rahçe 2, deklaroi drejtori Veskovski pas vizitës së kaptazheve Rahçe 1 dhe Rahçe 2. Shilegov theksoi se ujin të cilin e pinë qytetarët e Shkupit është i sigurt dhe është e pamundur të jetë i ndotur. Uji i Shkupit, siç tha, është një prej ujërave më të mirë në Evropë.

KABINETI I ZAEVIT PUBLIKON PËRGJIGJEN DREJTUAR BFI-së

## BFI kërkon ndërtimin e xhamive, Qeveria ankohet për shantazh

*Shkup, 22 mars* - Qeveria e Maqedonisë të Veriut e ka publikuar përgjigjen drejtuar Sulejman Rexhepit, pas letres së marrë nga Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë, e cila siç thuhet në reagimin e Qeverisë, përmban një shantazh, kërcënime dhe ultimatum për lëndë për të cilët zhvillohen procedura para institucioneve kompetente. BFIM i ka nisur ditë më parë Qeverisë një letër lidhur me obstrukcionet që institucione dhe zyrtar të caktuar po i bëjnë rindertimeve të xhamisë "Ali Pasha" në Ohër, në fshatin Llazhec të Manastirit dhe në xhaminë "Husamedin Pasha" në Shtip.

"Të nderuar, në lidhje me letrën e pranuar nga ana Juaj, themi se i njëjti paraqet formë të paprueshme të drejtimit ndaj institucioneve shtetërore, e cila është një lloj shantazhi dhe kërcënimi, për

ç'arsye seriozisht mendojmë për të njëjtën ta informojmë prokurorinë publike kompetente. Në letër përmenden disa lëndë, për të cilat zhvillohen procedura para institucioneve kompetente, e cila është e pavarur nga pushteti ekzekutiv, ndërsa bazohet dhe varet nga respektimi i ndërsjellë i të drejtës pozitive në vend", thuhet në përgjigjen e Qeverisë drejtuar BFI-së.

Sipas Kushtetutës, vazhdon më tej reagimi, si akt më i lartë ligjor, Republika e Maqedonisë së Veriut është shtet sekular, ndërsa ky pushtet ekzekutiv asnjëherë nuk do të ndërmarrë masa me të cilat do t'i manipulojë ndjenjat fetare apo do të përzihej në marrëdhëniet brenda bashkësive fetare apo mes tyre. "Në këtë drejtim i hedhim poshtë të gjitha akuzat se cilado bashkësi fetare është e favorizuar në



vend, ndërsa akuzën e tillë e vlerësojmë si tendencioze dhe paushalle. Nëse te Ju i nderuar, ekziston dyshimi apo indice se ndonjë institucionet i ka shkelur dispozitat pozitive ligjore Ju inkurajojmë si Reisul i BFI-së të inicioni procedurë përkatëse para organeve me kërkesë adekuate ligjore. Rëndësi të posaçme ka të theksojmë se në shoqërinë multikonfesionale të

drejtat dhe lirit fetare dhe qytetare realizohen përmes procesit ekzistues për ndërtimin e besimit të ndërsjellë mes konfesioneve të ndryshme, e jo përmes ultimatumëve, të cilat si rregull të lojës nëse i pranojnë të gjitha bashkësitë e regjistruara fetare, seriozisht në mënyrë negative do të reflektoheshin ndaj kohezionit shoqëror".

(O.Xh)



MUNGESA E KUADRIT MJEKËSOR

# PUNËSIMET, PAS ZGJEDHJEVE PRESIDENCIALE

Shoqata e Mjekëve Shqiptar e ndjek me vëmendje këtë problem dhe sipas vërejtjeve të kësaj shoqate, përzgjedhja e kandidatëve të rinj do të vonohet shumë për shkak të zgjedhjeve presidenciale

Koha Delvina KËRLUKU

Shkup, 22 mars - Mungesa e kuadrit mjekësor nëpër institucione shëndetësore, sidomos e gjinekologëve, anesteziologëve, internistëve, ende mbetet problematike. Ministria e Shëndetësisë, ka paralajmëruar punësimin e mjekëve, por pas zgjedhjeve presidenciale.

Mungesa e stafit mjekësor ndikon në uljen e cilësisë së shërbimeve, kurse pacientët janë ata që e pësojnë më së tepërmi, ndërkohë që organizatat që merren me veprimtari shëndetësore ngrenë zërin kundër punësimeve të dirigjuara nga politika. Në anën tjetër, ka një numër të madh të infermierëve dhe mjekëve që kanë kryer shkollimin dhe presin në Agjencinë e punësimit. Kryetar i Shoqatës së infermierëve në Gostivar, Xhavit Saliu, shprehet i shqetësuar sa i përket mungesës së kuadrit mjekësor dhe kjo, sipas tij, vërehet më së tepërmi në spitalin të Gostivar, por edhe nëpër Kli-



nikat në Tetovë, Shkup. Ai e quan gabim kur politikanët kërkojnë zgjedhje, për të zgjidhur problemet shëndetësore.

Shoqata e Mjekëve Shqiptar e ndjek me vëmendje këtë problem dhe sipas vërejtjeve të kësaj shoqate përzgjedhja e kandidatëve të rinj do të vonohet shumë për shkak të zgjedhjeve presidenciale. "Disa nga konkuret kanë përfunduar, ndërsa procedura e zgjedhjeve presidenciale është më vonë dhe deri më tani do të kishte përfunduar përzgjedhja e kandidatëve dhe punësimi i tyre. Kjo ndikon që në mënyrë indirekte mjekët e rinj që të dëshpërohen. Këto punësime janë të domosdoshme, kur është në pyetje shën-

deti", tha dr.Nevzat Elezi, kryetar i Shoqatës së mjekëve shqiptar.

Ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe, edhe përkaj vonesave të punësimit të stafit mjekësor, thotë se pas përfundimit të zgjedhjeve presidenciale, do të punësohen mjekë, kurse në shtator edhe mjekët e rinj do të marrin licencë pune, ku edhe është paraparë buxhet për pagat e tyre. "Ne po bëjmë të pamundurën që ta forcojmë sistemin si në blerjen e pajisjeve, poashtu edhe në punësim të mjekëve dhe motrave medicinale. Vitin e kaluar, një numër i madh i mjekëve dhe motrave dhe personelit në institucionet shëndetësore publike janë punësuar dhe tani do punësohen 40 mjekë

në Shtëpinë e Shëndetit në Shkup, kurse nga shtatori 250 mjekë të rinj që do të fitojnë licencë, do të marrin paga pikërisht në nivel primar", tha Venko Filipçe, ministër i Shëndetësisë.

Përderisa nga Ministria e Shëndetësisë paralajmërojnë punësim të personelit mjekësor, nga ana tjetër shumë mjekë të ri po e lëshojnë vendin.

Vendet e zhvilluara të Evropës, kryesisht Gjermania, Austria, etj. janë destinacionet më të shpeshta të mjekëve të rinj, pasi kanë vështirësi për të vazhduar specializim dhe më pas për të gjetur punë. Por, jo vetëm kaq, mjekët shpesh herë ankohen edhe për paga të ulta.

QYTETI I SHKUPIT ME APEL DREJTUAR SARAJIT



Platformat në Matkë, Bexheti të respektojë ligjin

Shkup, 22 mars - Qyteti i Shkupit i ka bërë thirrje Komunës së Sarajit që të veprojë në pajtim me kompetencat ligjore lidhur me platformat joligjore në Matkë. "Qyteti i Shkupit e inkurajon komunën e Sarajit që të veprojë në pajtim me kompetencat e veta ligjore kur janë ndërtimet joligjore në pyetje. Në të vërtetë, nuk ka interes më të madh as për qytetarët e Shkupit, as për qytetarët e Sarajit sesa sundimi i së drejtës, barazia para ligjeve dhe funksionimi i tërësishëm i institucioneve", deklaroi zëdhënësi i Qytetit të Shkupit, Valon Saliu. Ai tha se vitin e kaluar Qyteti së bashku me UNDP-në dhe Ministrinë e Mjedisit të Jetesës dhe Planifikimit Hapësinor kanë përpunuar modele ligjore, me të cilat do të mbrohet Matka në kuptimin ekologjik dhe ekonomik. "Kjo zgjidhje do të mundësojë mbrojtjen e Matkës dhe menaxhimin e saj të mos varet nga kryetari i Qytetit të Shkupit ose kryetari i komunës së Sarajit, por nga respektimi i ligjit. Matka është potencial i jashtëzakonshëm për tërë qytetin, e posaçërisht për popullatën lokale të Sarajit", tha Saliu. Paraprakisht sot kryetari i komunës së Sarajit, Blerim Bexheti deklaroi se komuna nuk do t'i legalizojë platformat joligjore në Matkë, por se nuk mund as t'i rrenojë, pasi kanë kërkesa për legalizim. (Q.A)

## NIVEL I ULËT I PROKURIMEVE NË KOMUNAT E SHKUPIT

Rezultatet tregojnë se në 10 komuna ekziston një nivel i lartë prezantimi i elementeve diskriminuese në dokumentet e tenderit, të cilat mund të rregullohen nga konkurrenca. Elementet diskriminuese ndikojnë në zvogëlimin e numrit të ofertave të pranuar pas një thirrje të publikuar për shpallje

Koha Qesere ABDYLI

Shkup, 22 mars - Vetëqeverisja lokale në rajonin e Shkupit në vitin 2017 përfundoi me 33 kontratat e prokurimit publik pa shpallje publike. Vlera e përgjithshme e këtyre prokurimeve ishte 1.36 milion euro, nga të cilat 40 për qind, ose 548 mijë euro nga këto kontrata i takojnë Qytetit të Shkupit. Kjo u demonstrua nga monitorimi i prokurimeve publike të vetëqeverisjes lokale në rajonin e Shkupit të prezantuar në projektin "Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies së komunave në shpenzimin e fondeve publike", nga Shoqata e Gazetarëve Ekonomikë, e cila sot pre-

zantoi dhe rezultatet.

"Anketa e prokurimeve publike nga vetëqeverisja lokale në rajonin e Shkupit për vitin 2017 tregoi se kishte një nivel rekord të ulët të prokurimit publik. U nënshkruan 809 kontrata publike të prokurimit në vlerë totale prej 2.15 miliard denarë, do me thënë 35 milion euro. Vetëqeverisjet lokale, shumica dërmuese e tyre nuk arrijnë një nivel të lartë të realizimit të planit të prokurimit publik. Shqetësuese është fakti se një numër i madh i komunave në rajonin e Shkupit nuk kanë një sistem për monitorimin e zbatimit të kontratave të përfunduara", tha Marija Georgievska, drejtoreshë e SHGE-së. Rezul-

tatet tregojnë se në 10 komuna ekziston një nivel i lartë prezantimi i elementeve diskriminuese në dokumentet e tenderit, të cilat mund të rregullohen nga konkurrenca. Elementet diskriminuese ndikojnë në zvogëlimin e numrit të ofertave të pranuar pas një thirrje të publikuar për shpallje.

German Filkov nga Qendra për komunikime civile vuri në dukje se transparenca mesatare e prokurimeve publike në komunat e vendit është 51.9 për qind, ndërsa institucionet në nivel kombëtar 51.6 për qind. Sipas tij, niveli më i ulët i transparencës në vend është në Komunën e Shuto Orizares, ndërsa më i larti në Veles, Krushevë dhe

Ohër.

"Po ndjekim ciklin e prokurimit publik nga shfaqja e një nevojë për të blerë diçka, duke zbatuar procedurën deri në realizimin e kontratës. Për fat të keq, faza e parë është planifikimi dhe përcaktimi i nevojave dhe monitorimi i fundit i zbatimit të kontratave. Këto janë dy faza që nuk mbulojnë nga Ligji aktual i prokurimit publik", tha Filkov. SHGE bëri hulumtimin e komunave nga rajoni i Shkupit dhe shtatë organizata të tjera joqeveritare në shtatë rajonet e tjera të vendit, Qendra për komunikime civile zbaton monitorimin e prokurimeve publike të institucioneve në nivel kombëtar.



Republika e Maqedonisë së Veriut  
Ministria e bujqësisë, pylltarisë  
dhe ekonomisë së ujërave

SEKTORI PËR ZHVILLIM RURAL



NUMRI ARKIVOR: 14

Në bazë të nenit 101 paragrafi (7) i Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 49/2010, 53/2011, 126/2012, 15/2013, 69/2013, 106/2013, 177/2014, 25/2015, 73/2015, 83/2015, 154/2015, 11/2016, 53/2016, 120/2016, 163/2016, 74/2017, 83/18 dhe 27/19), nenit 4 paragrafi 2 alineja 2 dhe nenit 12 paragrafi 1 i Rregullimit për llojin e aktiviteteve, shumën maksimale për aktivitetet, shfrytëzuesit, subjektet që marrin pjesë në procedurën, kriteret e përafërta dhe mënyrën për ndarje të mbështetjes teknike në bujqësi, dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 6/13, 81/13, 181/13, 1/14, 23/14, 136/14, 157/14, 139/15, 215/15, 133/16,76/18, 100/18 dhe 127/18) dhe pjesa II paragrafi (2) pika 1 nënpika 1.1 e Programit për mbështetje financiare të zhvillimit rural për vitin 2019 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 23/19), Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave publikon:

THIRRJE PUBLIKE

PËR SHFRYTËZIM TË MBËSHTETJES TEKNIKE PËR ORGANIZIM DHE REALIZIM TË MANIFESTIMEVE PËR PROMOVIM TË PRODHIMEVE BUJQËSORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

I. Lëndë e thirrjes publike

Parashtrimi i propozimit për shfrytëzim të mbështetjes teknike për organizim dhe realizim të manifestimeve për promovim të prodhimeve bujqësore në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga sfera e bujqësisë, zhvillimit rural, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave (në tekstin e mëtejshëm: propozimi për shfrytëzim).

II. Të drejtë për pjesëmarrje në procedurë

Të drejtë për pjesëmarrje në thirrjen publike kanë njësitë e vetëqeverisjes lokale, shoqatat nga sfera e bujqësisë, zhvillimit rural, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave të regjistruar në pajtim me Ligjin për shoqata dhe fondacione, odat ekonomike të themeluara në pajtim e ligjin, kooperativat e regjistruara në pajtim me Ligjin për kooperativa ose Ligjin për kooperativa bujqësore për kryerje të veprimtarisë bujqësore dhe/ose për tregti me prodhime bujqësore dhe/ose ndërmarrje publike të regjistruara dhe për kryerje të veprimtarisë organizim të panairëve dhe manifestimeve panairësh.

III. Përmbajtja e propozimit dhe dokumentacioni i nevojshëm

Pjesëmarrësit në thirrjen publike duhet të parashtrorjnë:

1. Propozim për shfrytëzim;
2. Të dhëna për propozuesin;
3. Titulli dhe rezymeja e propozimit;
4. Përshkrimi i propozimit (përshkrim i gjendjes ekzistuese, qëllimet e vendosura dhe rezultatet e pritshme);
5. Plani i aktiviteteve me kornizë kohore për realizim të propozimit për nga aktivitetet dhe metodologjia e realizimit të tyre;
6. Plani financiar i shpenzimeve, korniza kohore për realizimin e tyre dhe burimet financiare;
7. Ndikimi i propozimit në kuptim të qëndrueshmërisë së mëtejshme të aktiviteteve, grupi i qëllimeve gjegjësisht përshkrimi i shfrytëzuesve të drejtpërdrejtë ose indirekt të rezultateve nga aktiviteti, zbatimi i mëtejshëm i rezultateve dhe efektet e pritshme për shfrytëzuesit;
8. Llogaria bankare ku duhet të paguhet mbështetja;
9. Dëshmi për mbajtje të vazhdueshme të manifestimit në tri vitet e fundit, me përjashtim të manifestimeve që organizohen për herë të parë ose të dytë (kopje të marrëveshjes së lidhur me MBPEU "Marrëveshje për shfrytëzim të mbështetjes financiare për organizim dhe realizim të manifestimit lokal").
10. Propozim projekt;
11. Gjendja aktuale nga Regjistri qendror;
12. Rekomandime ose dëshmi të tjera për implementim të mëhershëm të propozimeve të tjera të ngjashme;
13. Për aplikuesit subjekte juridike: vërtetim për evidencë në ZHEEB (nëse merren me prodhimtari bujqësore primare), dëshmi nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë se nuk është iniciuar procedurë falimentimi ose likuidimi dhe dëshmi nga Drejtoria për të hyra publike për tatime dhe pagesa tjera publike të paguara;
14. Për shoqatat dhe odat ekonomike: program vjetor për punë me aktivitetet të përfshira nga propozimi i miratuar në pajtim me aktet statutare;

IV. Parashtrimi i propozimit

Propozimi parashtrorët në një kopje origjinale të nënshkruar nga personi i autorizuar i propozuesit. Një propozues mund të merr pjesë në procedurë për shfrytëzim të mbështetjes teknike për organizim dhe realizim të manifestimeve për promovim të prodhimeve bujqësore në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga sfera e bujqësisë, zhvillimit rural, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave vetëm me një propozim për shfrytëzim.

Propozimet mund të parashtrorhen nga dita e publikimit të thirrjes publike në ueb faqen e Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave dhe në shtypin ditor deri më (31.05.2019).

Propozimet parashtrorhen deri te Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave, rr. Aminta Treti nr. 2, 1000 Shkup, Sektori për zhvillim rural.

V. Shpenzimet dhe propozimet e pranueshme

Shpenzimet e pranueshme për organizim dhe realizim të manifestimeve janë:

- Shpenzimet për qira të hapësirës për ekspozimin e prodhimeve bujqësore (primare dhe të përpunuara);
- Shpenzime për huazim të shtandëve dhe rregullim dhe pajisje të pjesës ekspozuese (shtand, binë, audio dhe video pajisje) dhe/ose
- Shpenzime për material promovues (ftesa, afishe, fletushka, banerë, publikime, katalog, fjalorth, promovim medial për manifestimin dhe
- për pjesëmarrësit (shpenzimet për prodhim ekspozues) që ekspozojnë prodhime bujqësore (primare dhe të përpunuara).

Të pranueshme janë propozimet që janë nga sfera e bujqësisë, zhvillimit rural, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave dhe që përmbushin kushtet e caktuara në Rregulloren për llojin e aktiviteteve, shumën maksimale për aktivitetet, shfrytëzuesit, subjektet që marrin pjesë në procedurë, kriteret më të përafërta dhe mënyra e ndarjes së mbështetjes teknike në bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 6/13, 81/13, 181/13, 1/14, 23/14, 136/14, 157/14, 139/15, 215/15, 133/16,76/18, 100/18 dhe 127/18).

VI. Mënyra dhe shuma e pagesës së mjeteve financiare

Shuma maksimale e mbështetjes së lartpërmendur teknike nuk mund të tejkalojë 120.000,00 denarë për manifestim dhe shfrytëzues.

Shuma e mbështetjes së lejuar do të definohet me lidhje të marrëveshjes mes Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave dhe me organizatorin e manifestimit.

Pagesa e mjeteve financiare bëhet pas nënshkrimit të marrëveshjes në shumë prej 100% të shumës së shpenzimeve të pranueshme, por jo më shumë se shumën maksimale dhe në pajtim me mjetet e miratuara në programin për mbështetje financiare të bujqësisë dhe zhvillim rural.

VII. Shtojcat e thirrjes publike

Për përgatitje të propozimit për shfrytëzim, Ministria në ueb faqe [www.mzsv.gov.mk](http://www.mzsv.gov.mk), publikon Udhëzimet të detajuar për përpilim të propozimit për shfrytëzim të mbështetjes teknike për organizim dhe realizim të manifestimeve për promovim të prodhimeve bujqësore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Organizatori i manifestimit obligohet që krahas logos së institucionit të tyre të vendoset edhe logoja e Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave.

Informacione shtesë mund të merren në Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave në numrin e telefonit 02/ 31 34 477 ose në ueb faqen e Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave [www.mzsv.gov.mk](http://www.mzsv.gov.mk)

Përpiloi: Biljana Damçeska  
Kontrollor: m-r Valentina Stojanoviq – Tufa  
Miratoi: Trajan Dimkovski

MINISTËR  
Lupço Nikolovski

UDHËZIM

PËR PËRGATITJE TË PROPOZIMIT PËR SHFRYTËZIM TË MBËSHTETJES TEKNIKE PËR ORGANIZIM DHE REALIZIM TË MANIFESTIMEVE PËR PROMOVIM TË PRODHIMEVE BUJQËSORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

I. TË DHËNAT E PROPOZUESIT

EMRI I PROPOZUESIT:

TË DHËNAT PËR KONTAKT:

Adresa:

Telefoni/faksi: \_\_\_\_\_

E-mail: \_\_\_\_\_

PERSONI PËRGJEGJËS PËR ORGANIZIM DHE REALIZIM TË MANIFESTIMIT

Emri dhe mbiemri:

Nënshkrim:

DATA E PARASHTRIMIT TË PROPOZIMIT: \_\_\_\_\_

V. V

TITULLI DHE REZYMEJA E PROPOZIMIT PËR SHFRYTËZIM (PËRMBAJTJE E SHKURTË E PROPOZIMIT)

Në jo më shumë se një faqe të numërohen qëllimet që duhet të arrihen me propozimin për shfrytëzim, rezultatet e pritshme, aktivitetet për secilin prej rezultateve, korniza kohore për arritje të rezultateve të pritshme dhe shuma e kërkuar nga Programi për mbështetje financiare të zhvillimit rural për vitin 2019.

III. PËRSHKRIMI I PROPOZIMIT PËR SHFRYTËZIM

1. PËRSHKRIMI I GJENDJEVE EKZISTUESE
2. QËLLIMET E VENDOSURA
3. REZULTATET E PRITSHME

IV. PLANI I AKTIVITETEVE ME KORNIZË KOHORE TË PROPOZIMIT PËR AKTIVITETE DHE METODOLOGJIA PËR REALIZIMIN E TYRE

1. Fillimi i aktiviteteve është më \_\_\_\_\_ viti, ndërsa fundi i aktiviteteve është më \_\_\_\_\_ viti.
2. Mënyra (metodologjia) për realizimin e aktiviteteve është: \_\_\_\_\_.
3. Propozim projekt me plan të aktiviteteve \_\_\_\_\_.

V. PLANI FINANCIAR I SHPENZIMEVE TË PLANIFIKUARA, KORNIZA KOHORE DHE BURIMET E FINANCIMIT

1. Plani financiar përmban shpenzimet e planifikuara për realizim të manifestimit:
  - Shpenzimet e planifikuara për realizim të manifestimit duhet të jenë në pajtim me shpenzimet e pranueshme të përcaktuara në nenin 4 paragrafi 1 i Dispozitës për llojin e aktiviteteve, shumën maksimale për aktivitetet, shfrytëzuesit, subjektet që marrin pjesë në procedurë, kriteret më të përafërta dhe mënyra e ndarjes së mbështetjes teknike në bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 6/13, 81/13, 181/13, 1/14, 23/14, 136/14, 157/14, 139/15, 215/15, 133/16,76/18 ,100/18 dhe 127/18);
2. Plani financiar duhet të përmbajë burim të financimit;
3. Llogari bankare në të cilën duhet të paguhet mbështetja.

VI. NDIKIMI I PROPOZIMIT

Propozimi për shfrytëzim të përkrahjes financiare duhet të përmbajë edhe qëndrueshmëri pas përfundimit të aktiviteteve:

- Qëndrueshmëri të propozimit;
- Target grupi për të cilin është dedikuar manifestimi lokal;
- Numri dhe përshkrimi i shfrytëzuesve direkt dhe indirekt të rezultateve nga aktivitetet;
- Zbatimi i mëtejshëm i rezultateve dhe
- Efektet e pritshme për shfrytëzuesit përfundimtar.

VII. SË BASHKU ME PROPOZIMIN PARASHTRORHEN DOKUMENTET NË VIJIM:

1. Gjendja aktuale nga Regjistri;
2. Rekomandime ose dëshmi të tjera për implementimin e mëhershëm të propozimeve të ngjashme;
3. Për aplikuesit subjekte juridike vërtetim për evidencë në ZHEEB (nëse merren me prodhimtari primare bujqësore), dëshmi nga Regjistri qendror se nuk është iniciuar procedurë falimentuese dhe likuiduese dhe dëshmi nga Drejtoria për të ardhura publike për tatime dhe pagesa tjera publike të paguara;
4. Për shoqatat dhe odat ekonomike, program vjetor për punë me aktivitetet të përfshira nga propozimi i miratuar në pajtim me aktet statutare;
5. Dëshmi për mbajtje të vazhdueshme të manifestimit në tre vitet e fundit, me përjashtim të manifestimeve që organizohen për herë të parë ose të dytë (kopje nga marrëveshja e lidhur me MBPEU).

VIII. BUXHETI I PROPOZIMIT PËR SHFRYTËZIM

Propozimi duhet të përmbajë shumë të shpenzimeve të planifikuara përmes pikave si dhe shumën e përgjithshme e kërkuar e mbështetjes teknike për organizim dhe realizim të manifestimeve për promovim të prodhimeve bujqësore në Republikën e Maqedonisë së Veriut të shprehur në denarë me tatim të llogaritur të vlerë së shtuar.



NË MESIN E FSHATRAVE TË LIKOVËS

# PËRGJYSMOHET KARADAKU




Numri i nxënësve në klasë të parë është përgjysmuar, ndërsa çdo ditë e më shumë të rinjtë mbushin autobusët drejt Evropës. Edhe toka, që dikur siguronte bukën e gojës, tashmë ka mbet shkretë. Likova vazhdon të zbrazet, ndërsa pengimi i kësaj dukurie duket larg, për të mos thënë nuk duket fare

Likovë, 22 mars - Likova po zbrazet. Ashtu sikurse fshatrat tjerë të Karadaku, në Likovë tashmë mungojnë rreth 30 përqindëshi i të rinjve. Mungesa e infrastrukturës, e ardhmja e sigurt dhe papunësia në rritje çdo ditë e më shumë duket se po le shkretë këtë fshat me mijëra banorë.

Edhe numri i nxënësve në shkollën fillore "Dituria" po bie dukshëm. Nëse pas liberalizimit të vizave më 2009, Likova ishte qendër e vëmendjes me ikjet masive, tashmë shpërngulja vazhdon në heshtje. Investime të mëdha nuk janë zhvilluar as 18 vjet pas luftës së vitit 2001, ndërsa uji i pijshëm mungon edhe pse mbi fshat gjenden dy pëndat që furnizojnë me ujë madje Kumanovën me rrethinë.

Shaban Veseli, kryetar i Bashkësisë Lokale në Likovë, thotë se problemi kryesor është ikja të rinjve nga gjendja e rëndë ekonomike. "Problemin më të madh e kemi migracionin. Përafërsisht, sipas vlerësimeve jozyrtare, afër 30 për qind e rinisë është largua nga Komuna jonë. Shkaku kryesor i ikjes është situata ekonomike, por edhe poli-




SHABAN VESELI

**Problemin më të madh e kemi migracionin. Përafërsisht, sipas vlerësimeve jozyrtare, afër 30 për qind e rinisë është largua nga Komuna jonë. Shkaku kryesor i ikjes është situata ekonomike, por edhe politike. Shihet se njerëzit nuk kanë perspektivë, megjithëse aktualisht ka ndryshuar me investime... shumë objekte janë ndërtuar dhe shpresoj se edhe në të ardhmen do të investohet më shumë**

tike. Shihet se njerëzit nuk kanë perspektivë, megjithëse aktualisht ka ndryshuar me investime... shumë objekte janë ndërtuar dhe shpresoj se edhe në të ardhmen do të investohet më shumë", shprehet Veseli.

Dikur, për fshatarët e Komunës së Likovës, bujqësia ka qenë primare në sigurimin e jetesës, por me kalimin e viteve - punimi i tokës po zhduket dalëngadalë. Të paktë janë ata që sigurojnë bukën e gojës nga bujqësia.

"Dega kryesore ka qenë bujqësia, por tani nuk punohet toka. Shteti duhet të ndajë mjete për zhvillimin e bujqësisë, gjë që duhet ta marrin më seriozisht situatën në vendbanimet rurale. Përveç rritjes ekonomike, zhvillimi dhe investimet në bujqësi do të ndihmojnë në parandalimin e ikjes së të rinjve", shprehet Veseli. Në infrastruk-



BESNIK ARIFI

**Gjatë çdo viti kemi rënie të numrit nga 4-5 nxënës. Në vitin shkollor 2013/14, kemi pasur 41 nxënës në klasën e parë, ndërsa një vit më vonë (2014/15), vetëm 36 nxënës. Në 2015/16 kishim 33 nxënës, në 2016/17 - 34 nxënës, kurse në 2017/18 numri ka rënë në 20, do të thotë për 50 për qind u ul numri...**

turë, kryetari i Bashkësisë Lokale thotë se gjërat kanë ndryshuar për të mirë, megjithëse akoma ka punë që duhet bërë. "U ndërtua gjimnazi 'Ismet Jashari', u rregullua shtrati i lumit, bekatonizim dhe asfaltim i rrugëve të fshatit, por edhe në fshatrat tjerë të komunës, hapjen e spitalit, ndërsa zgjidhja e problemit me ujë dhe pijshëm dhe është nga fundi...".

Mungesa e shpresës për një jetë më të mirë dhe të sigurt financiarisht, thonë studentët, është arsyeja kryesore pse çdo ditë e më shumë braktiset vendlindja. Semra Mamuti, studente nga Likova, thotë se shteti ka vite që nuk ofron perspektivë për të diplomuarit, pasi politika tashmë ka partizuar çdo pore të shoqërisë. "Aktualisht, Maqedonia për studentët dhe të diplomuarit nuk ofron asgjë, gjithçka është partizuar. Kështu që, si shumë të tjerë, jam pesimiste se gjërat do të rregullohen", shprehet Mamuti, ndërsa shton se, shumë të diplomuar, nuk kanë një vend pune të sigurt, ndërsa zgjidhja e

vetme u mbetet braktisja e vendit.

Se Likova po zbrazet konfirmohet edhe nga rënia çdo ditë e më shumë e numrit të nxënësve, si në shkollat fillore, ashtu edhe në ato të mesme. Drejtori i shkollë fillore "Dituria", Besnik Arifi, në një bisedë për gazetën KOHA, thotë se gjatë çdo viti ulet numri i nxënësve, ndërsa shpërnguljet - përveçse jashtë shtetit, po bëhen edhe në drejtimin fshat-qytet. Kjo po zbraz edhe fshatin në tërësi.

"Gjatë çdo viti kemi rënie të numrit nga 4-5 nxënës. Në vitin shkollor 2013/14, kemi pasur 41 nxënës në klasën e parë, ndërsa një vit më vonë (2014/15), vetëm 36 nxënës. Në 2015/16 kishim 33 nxënës, në 2016/17 - 34 nxënës, kurse në 2017/18 numri ka rënë në 20, do të thotë për 50 për qind u ul numri. Këtë vit shkollor (2018/19) kemi 38 nxënës, kjo do të thotë është një rënie e numrit të nxënësve. Këtu duhet theksuar se nxënësit nuk zhvendosen vetëm në shtetet perëndimore, por kemi shpërngulje edhe prej fshatit në fshat ose prej fshatit në qytet...", tregon drejtori Arifi.

Likova në fakt është pasqyra e asaj çfarë po ndodhë edhe në fshatrat tjerë. Në këto fshatra, zor të gjenden punëtorë të rinj që do punonin në ndërtimtari apo edhe në biznese tjera të vogla. Të rinjtë nuk duken rrugëve apo lokaleve të fshatit. Moshë e mesme dhe ata më të moshuarit tashmë kanë mbetur vetëm. Në bisedë e sipër, në fshatrat e Likovës tashmë hapur flitet se, nga të rinjtë që kanë ikur, një komunë ndoshta më e madhe sesa është në Maqedoni, mund të themelohet në Evropë nga të rinjtë e Sllupçanit, Mateçit, Hotlës, Vaksincës, Llojanit, Orizarës dhe nga fshatrat tjerë.

(Semra dhe Suejla QAILI)

## Shkup, pesë të lënduar në nëntë aksidente

Shkup, 22 mars - Pesë persona kanë marrë lëndime të lehta në tre prej nëntë fatkeqësive të komunikacionit që kanë ndodhur gjatë njëzet e katër orëve të kaluara në rajonin e Qytetit të Shkupit. Në gjashtë është shkaktuar dëm material. Policia, sipas të dhënave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, nga komunikacioni i ka përjashtuar 45 shoferë të cilët kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe se shpejtësia e lejuar, 24 para se të fitojnë të drejtën e drejtimit të automjetit dhe tre fillestarë. Janë sanksionuar edhe tre shoferë për automjete me defekte teknike, 21 të paregjistruara dhe 144 për parkim jo të rregullt. Me automjetin special "karrotreci" janë larguar 82 automjete. Janë dënua edhe tre këmbësorë të cilët e kanë kaluar rrugën jashtë vendkalimit për këmbësorë, nga katër për kalimin e rrugës dhe udhëkryqit në semafor të kuq, katër shoferë të cilët nuk u kanë dhënë përparësi kalimi këmbësorëve në vendkalim të shënuar për këmbësorë, dy për rreshtim jo të drejtë. Janë shqiptuar edhe tetë gjoba për mosmbajtjen e helmetës mbrojtëse drejtuesit e biçikletës me motor, mopedit dhe motoçikletës, si edhe pesë për mosmbajtjen e rripit të sigurisë gjatë drejtimit të automjetit motorik. (O.Xh)

## Nuk ka nevojë për panik nga bakteri MRSA

Shkup, 22 mars - Inspektorati Sani-tar Shëndetësor dhe Qendra e Shëndetit Publik këtyre ditëve kanë bërë inspektimin gjendjes në terren, me qëllim të parandalimit të përhapjes së bakteries MRSA, me ç'rast janë evidentuar disa raste të fëmijëve të prekur nga kjo bakterie në kopshtin 'Borëbardha' në Shkup. Pas ekspertizave të bëra, është konstatuar se janë tre fëmijë të prekur nga kjo bakterie, me të cilët po merret Instituti i Mikrobiologjisë, ndërkohë që janë marrë masat që të dezinfektohen të gjitha objektet shkollore në komunën e Çairit. Nga Qendra e Shëndetit Publik informojnë se nuk ka raste të reja të të infektuarve me bakterin MRS, por prindërit e shqetësuar i kanë dërguar në kontroll fëmijët e tyre. Mjekët apelojnë që të mos bëhet panik, nëse nuk ka shenja klinike të infeksionit. Sipas analizave të Inspektoratit Shëndetësor ky lloj i bakteries MRSA është i shërueshme me krem antibiotik që përdoret për hundë. Mjekët amë tash më disponojnë me udhëzimet e nevojshme për pacientët, kurse shkollat në dy komunat e Shkupit, nuk janë mbyllur tashmë dhe vazhdojnë procesin mësimor. (D.K)

# Traditat e huaja s'bëhen tonat



Nga  
Daut DAUTI

## KARNEVALET APO NETËT E SHTRIGAVE?

Të dielën e 10 marsit, pata një rast të rrallë që të jem një nga mysafirët në Karnevalet Ilire të fshatit Bozovcë. Një manifestim i bukur dhe tradicional, për të 11 herë. Manifestimet e mëparshme, publiciteti dhe parajmërimet në rrjetet sociale dhe media bëri që përveç banorëve të këtij fshati, të vinin edhe nga fshatrat përreth dhe nga qyteti (i Tetovës), por dikush edhe nga më larg. Një manifestim i bukur me elemente të traditës. Kur numëron 11 (vjet), shumëkush mund të thotë se është fjala për një traditë që nuk ka fort lidhje me doket tona, por një veprimtari kulturore që ka vulën e një njeriu entuziast, siç është z. Neshat Memedi, i cili është alfa dhe omega e karnevaleve. Por, nuk është ashtu, se në organizimet e mëparshme ka dhënë mjaft kontribut edhe prof. Fadil Sulajmani, filantropi Lazim Destani dhe të tjerë, siç janë vite me radhë edhe vëllezërit Jashar dhe Idajet Sejdiu, që kultivojnë melosin burimor të kësaj treve dhe që janë pjesë e pandashme e çdo viti... Por, 11 vjetët nuk mund të bëhen traditë, e as mund ta krijojnë, sepse traditë është ajo që me shekuj ka qenë pjesë e jetës, dokeve të një populli ose një mjedisi. Pikërisht të tilla duhen të trajtohen karnevalet ilire në Bozovcë, këtu është vlera e manifestimit. Këtu 11 vjetët janë kohë kur dikush e ka marrë përsipër që t'i futë në një shemë organizative, ndërkaq këto karnevale, siç mund të shihet edhe nga fotografitë që janë botuar nga dekada më herët, kanë qenë pjesë e festave të motmotit dhe kanë spontane.

Manifestimi në Bozovcë është një "marshim" etnuzastësh nëpër rrugët

e rrugicat e katundit, që lidhen pakashumë me ditën e motmotit (Ditën e Verës), çfarë në mënyra të ngjashme bëhen gjithandej trojeve shqiptare (kallin zjarre, ziejnë patate, "koka me foj", tambël oriz...), që kanë mbetur nga kohë më të lashta. Por, forma e karnevalit, praktikisht është e rrallë dhe e mban gjallë ky fshat dhe është për t'u përhëndetur dhe për ta mbetur pak më shumë, që të mos varen ato nga entuziazmi individual.

Këto ditë, me pamjet tërheqëse e interesante nga Bozovca, pati dhe disa mendime që karnevali të zbrisë në qytet. Në Maqedoninë ka disa karnevale që janë të njohura, si ai i fshatit Vevçan të Strugës, ose në Strumicë dhe Prilep, që sivjet mbajtën brenda një vikendi. Një karneval i ri, bie fjala në Tetovë do ta pasuronte atmosferën karnevaleske, por me rrezik të madh që ta humbte kuptimin e tradicionales dhe të merrte imitime nga karnevalet tjera jo vetëm të vendit por dhe nga më larg, duke iu nënshtruar trendeve moderne, me çka do të humbnin ndoshta kuptimin e asaj çka kanë nënkuptuar karnevalet ose elementet karnevaleske dikur.

Ajo që më cyti të shkruaj për karnevalin e Bozovcës, përveç përshtypjeve të bukura nga ruajtja e traditës, por duhet të jemi dhe realistë, me përmasa shumë larg karnevaleve që mbahen në qytete, është një trend tjetër që ka nisur të depërtojë në mjediset tjera. Në disa media ka nisur të trajtohen si ngjarje mediale (disa televizione kanë qenë dhe sponsorë medialë!!!), sikur të ishin pjesë e traditës sonë. Mund të ketë më shumë këso ngjarjesh "tendi". Unë personalisht nuk kam ndonjë problem me Shën Valentinin, ditën e të dashuruarve që

kur vjen në kalendar, mbushen plot urime rrjetat sociale e mediat, por simbolika e kësaj dite duket se është mjaft problematike dhe kontekst jo aq "të paqtë", nëse e shikojmë porosinë nga këndvështrimi i moralit. Edhe më bizar në pamje e përmbytje mund të jetë Nata e Shtrigave, për të cilën besoj se asnjë shqiptar nuk di, përveçse të ketë mbresa nga ata disa filma të famshëm horrori nga Holivudi? Kujt iu kujtua në Kosovë të bëjë "traditë" dhe manifestim tradicional, siç e kemi parë pikërisht natën e shtrigave!? Çfarë e lidh një shqiptar me Natën e Shtrigave që të bëhen spektakle të tilla? Ku e marrin frymëzimin iniciatorët për të na servirë...

Traditat dhe kulturat e popujve ndërthuren shpesh kur të kenë jetuar me shekuj bashkë. A janë me origjinë pagane ose fetare, ose të ndonjë karakteri tjetër (përralla, legjenda...), disa tradita të vjetra shpesh duken sikur të jenë marrë nga njëri tjetri. Edhe këto karnevale për të cilat po bëjmë fjalë kanë ngjashmëri por dhe ndryshime, por, shfaqen te popujt e këtij nënqielli. Çdo respekt shën Valentinave ose netëve të shtrigave që mund të kenë ndonjë kuptim për kontinentet tjera, por ato nuk kanë kurrfarë domethënie për ne. Prandaj mendoj se më mirë të ripërtërijmë ndonjë rrit tonin të harruar që është pjesë e traditës sonë, se sa të imitojmë në formën më vulgare diçka të largët.

Sepse, traditat e huaja mbeten të huaja, çfarëdo kuptimi që të kenë për popujt ku kanë lëshuar rrënjë. "Pema" e një nënqielli të largët nuk mund të shartohet në pemët tona, sepse mund të dalin fryte të egra... Më mirë t'i organizojmë këto karnevale të Bo-

**Çdo respekt shën Valentinave ose netëve të shtrigave që mund të kenë ndonjë kuptim për kontinentet tjera, por ato nuk kanë kurrfarë domethënie për ne. Prandaj mendoj se më mirë të ripërtërijmë ndonjë rrit tonin të harruar që është pjesë e traditës sonë, se sa të imitojmë në formën më vulgare diçka të largët**



zovcës, sado që të duken të thjeshta me ato maska autentike lëkure, se sa të bëjmë parada me maska që të dukemi shtriga e shtriganë sipas filmave hollywoodianë!

## TERRORIZMI NË KLISHE...

Pesëdhjetë viktima nga një dorë vrasare. Për të prishur idilin e një vendi vërtet të paqes dhe rendit, siç është Zelanda e Re. Nëse ka mundur të preket Zelanda, ku policinë e vend e kap mërzia ngase nuk kanë me se të merren, a mbetet më vend i sigurt në botë? Terroristi, i krishterë, viktimat myslimane. Akuza nga mbarë bota paqedashëse ndaj aktit barbar.

Përveç tragjedisë së madhe njerëzore ku u vranë në tempuj të perëndisë, në skenë riktheu gjitha stereotipet që dominojnë botën e ndarë në fe të ndryshme. Ato klishe që shprehen si aksioma, në të vërtetë kanë shumë pikëpyetje. Ja disa (që ranë në sy në formë komentesh në portale ose rrjetet sociale)...

(Jo)Barazimi i akteve të terrorizmit. Duke shprehur keqardhje dhe ngushëllim për viktimat, shumë myslimanë akuzuan botën (e krishterë) që nuk e dënon aq sa meriton aktin terrorist të një krishteri ndaj myslimanëve. Sepse 50 viktima nuk janë pak që të gjesht pretekste relativizmi, siç disa mendojnë se u informua në media. Gjëja e parë që vërejtën kritikuesit është se bëhet përpjekje për t'i dhënë tjetër dimension (ekstremizëm e jo terrorizëm), ose madje dhe si akt të një të sëmuri psikik.

Nuk jam fort i sigurt se shtypja botërore u përpoq ta relativizojë këtë akt makabër. Shokimi ishte i madh nga vetë fakti se ndodhi në një vend ku askush nuk ka mundur të presë,

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr. 11, | Q.T. Mavrovassja lok. 14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypja dhe distributimi: "Sloboden Peca" - rr. Kej 13 Noemvri nr. 31-238, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e premtë, 22 mars 2019 | Numri i parë i gazetës do të jetë 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjigjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distributim: Afrim DULLLOVI • Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirolllogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772



kurse ndonjë deklaratë sporadike siç ishte e një parlamenti i cili e lidhi çështjen si shkak-pasojë e ekspansionit mysliman, nuk mund të jetë argument, sepse i njëjti hasi në akuza të ashpra. Një tjetër klishe është se akte terroriste bëjnë edhe të krishterët, por bota flet dhe akuzon vetëm kur bëjnë myslimanët. Ose, te myslimanët i stërmadhojnë rastet, ndërsa te të krishterët minimizohen.

Duhet të merren me rezervë. Sepse nuk mbahet mend ndonjë rast me vrasje masovike, të jetë heshtur, kushdo që të ketë qenë kryesi, kushdo që të ketë qenë viktimë. Është e vërtetë se shkruhet për aktet terroriste që i bëjnë myslimanët, por nuk është e vërtetë se heshtjen kur akte të ngjashme bëjnë të tjerët. Dhe aktet terroriste nuk kanë përherë ngjyrë fetare e as viktimat dhe kryesit janë të ndarë në baza fetare. Akti që bëri një sektë japoneze ishte terrorist dhe viktimat ishin të të njëjtit popull apo fe dhe nuk ishin myslimanë. Aktet që i ka bërë ETA me viktimat masovike civile, e gjithë bota i ka akuzuar. Pokështu aktet që me vite i bënte IRA...Pra, nuk bëhet fjalë për atentate ose vrasje personash që personifikojnë shtetin ("okupator", diktatorial...), por civilë. A harrojmë sa mbulesë mediale ka pasur ndonjë akt terrorist nëpër shkolla, fakultete ose rrugë në Amerikë ku akti nuk ka pasur ndonjë motiv fetar ose etnik? Ndaj dhe kur dalim pastaj në terren të shteteve myslimane, shpesh nuk kemi viktimat njerëzore të fesë tjetër. PKK-ja kurde me vite ka vrarë civilë nëpër rrugët, sheshet, lagjet e qyteteve turke, me bomba të kurdisura, me akte vetëvrasëse ku nuk ka zgjedhur pjesëtarë të ndonjë kombi ose feje të caktuar, por rrethanat diktojnë që viktimat dhe kurdisësit e bombave të kenë qenë pikërisht të të njëjtës fer!. Motivët fetare këtu janë me pikëpyetje. Por, akti si akt është terrorist. Sa e kanë devalvuar kauzën në emër të së cilës janë bërë këto akte, s'ka nevojë të flitet! Sepse aktet terroriste devalvojnë çfarëdo kauze që në thelb mund të jetë e drejtë (lufta për të drejtë, ose lufta kundër okupatorëve...). Shumëkush harron se në aktet që ne i quajmë terroriste në disa shtete të okupuara myslimane (Irak, Liban, Avganistan...caqet e sulmeve të shpeshtën janë civilë dhe janë të të njëjtës fe. Sa akte terroriste janë bërë myslimanë ndaj myslimanëve, ose si në shembujt e mësipërm, të krishterë ndaj të krishterëve...

Të mos harrojmë se disa akte bëhen pikërisht për të bërë publicitet medial dhe s' duhet të na çuditin që arrijnë si lajme të para në media. Dhe a duhet që të injorohen nga publiku kur në pyetje janë viktimat njerëzore? Këto janë gjëra që as mund të fshihen, e as duhet të heshten vetëm pse si rast më i freskët ka ndodhur që të jetë një katil i krishterë të ketë vrarë dhjetëra myslimanë, që të harrohen rastet tjera ku kryerësit kanë qenë myslimanë, ose me këtë të gjejë ndonjë arsyetim.

Kushdo që t'i kryejë aktet, sidomos nëse e bën për motive fetare, janë për çdo akuzë, sepse para së gjithash, ato e komprometojnë fenë dhe komunitetin e tyre fetar, ndonëse edhe kjo mund të trajtohet si klishe, sepse asnjë vrasës, asnjë terrorist, asnjë ekstremist që luan me kodet fetare, nuk mund të përfaqësojë një fe...Prandaj dhe imamët tanë, duhet të mbajnë ligjëratat të zjarrta fetare për të gjitha aktet terroriste që ndodhin midis vetë myslimanëve.

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

## Bursa e tregut presidencial



Nga  
Dr. Arben TARAVARI

Titulli i shkrimit është sa ironik, sarkastik, cinik mirëpo fatkeqësi-sht dhe real. Tashmë zgjedhjet parlamentare, zgjedhjet lokale, zgjedhjet presidenciale dhe të gjitha zgjedhjet politiko-partiake janë kthyer në fushata marketingu me kurse valutore. Njësoj si bursa e Nju Jorkut ashtu edhe tek ne, ka përditë luhatje të valutës derisa shpallet fituesi.

Ana aspak e mirë e kësaj historie është që votat shikohen si valuta, si pare, si monedha. Varet se çfarë çmimi i vendos votuesi verdiktin të tij nëse vërtet kanë mbetur më njerëz që shesin lirinë e tyre, pasi nuk mendoj se ka shumë që po qëndrojnë në treg gati të blihen. Por promotorët e vërtetë të këtyre aferave janë vet partitë politike që e çojnë vëmendjen ndaj marrëveshjeve në tavolinë, ndaj pazarave "më jep-të jap". Kështu pafilluar ende mirë fushata, prej tash janë hedhur në terren pyetje të tipit: Çfarë do ndodhë në raundin e dytë të zgjedhjeve?! A po mos ndoshta vallja është caktuar shumë më përpara se të ftohen dasmorët? Të gjitha këto hamendësime janë pjesë e një fushate të mirëmenduar, të një strategjie e cila funksionon prej vitesh në vendin tonë të varfër e qyqar!

Rasti i kandidatit që mbështesim ne, z. Blerim Reka, ka rritur frikën e partive të vjetra, pasi si asnjëherë tjetër shqiptarë, maqedonas, turq, bullgarë, boshnjakë, romë e egjiptian po duan të votojnë Blerim Rekën si President, sepse ai është Kandidati i Popullit. Nga ankthi se z. Blerim Reka është kandidatura më serioze, më intelektuale, më diplomatike, parti apo qarqe të njohura tashmë, që nuk kanë bërë një ditë të ndershme në politikë, kanë filluar diskutonjë të vrasin mendjen si të mposhtin këtë hata që mund t'ju ndodhë para syve?!

Ajo që më bën përshtypje të madhe është mungesa e madhe e respektit që kanë partitë e vjetra (si BDI-ja p.sh, nuk ka më plakë se ajo), pra mungesa e konsiderate ndaj popullit, ndaj votuesit! Kështu duke bërë supozime mbi "marrëveshjet presidenciale" injorojnë krejtësisht vullnetin e popullit, madje i thonë "rri urtë dhe bindu" duke pretenduar që nuk ka aspak rëndësi vota e tyre, rëndësi ka menaxhimi që i bëhet votës së tyre!

Kjo është një logjikë diktatoriale e cila sipas ndërkombëtarëve e ka shtëpinë prapa hekurave, por nuk e di se me cilin guxim vazhdon ende operon në shtetin tonë? Ju kërkoj ndjesë për agresivitetin e pyetjes, por: more çfarë e dini popullin?! Letër higjienike që pastroni mender buzët sa herë bëheni pis apo njerëz që i shisni për të blerë euro, miliona euro, vila lukzose, prona të tundshme e të patundshme?! Ende mendoni se keni të drejtë të bëni pazare në sy të popullit në emër të gjoja "konsensusit"?! Ndjej racionalisht dhe instiktivisht se janë përpjekjet e fundit të një grupi të dëshpëruar njerëzish të cilët qëndrojnë në vendin e gabuar!

Është pluhuri i fundit që kërkon të ngrëjë një kalë tashmë i lodhur, plak e i rraskapitur, që jo vetëm nuk e ka dëgjuar të zotin, po e ka hedhur në tokë, e ka zvarritur me vite me radhë duke i shkaktuar plagë të thella! Ajo që më tepër pres është largimi imediat i të gjithë atyre individëve të cilët me pushtetin kanë rritur arrogancën e tyre, që dyshohen se janë të implikuar në krime të shumta, që dihet publikisht se kanë aurat e të fortëve, që besojnë se ekzistenca e tyre është 100 fish më e rëndësishme se ajo e të vdekshmëve të zakonshëm! Kthehemi edhe njëherë tek Zgjedhjet Presidenciale. Populli është i qartë për aftësitë e tij vendimmarrëse, dhe mbi të gjitha është sovran!!! Mos bëni pazare duke injoruar fuqinë absolute të popullit!

Duke shtruar dilema se si e qysh do të veprojnë Pendarovski apo Reka, duke zhvilluar dhënie-marrje votash në emër të popullit! Nuk e di për kandidatët e tjerë, nuk e di nëse mendojnë se kanë të drejtë të bëjnë pazare partiake me votat që kërkojnë kinse në emër të parimeve të një presidencie të mirë, por z. Blerim Reka qartë

**Duket se e di ekuacionin e pushtetit në shtetet demokratike, ku i pari vjen populli, ekuacion të cilin pushtetet në Maqedoninë e Veriut e kanë zgjidhur kaq keq, sa tashmë prej vitesh është krijuar një disbalans i jashtëzakonshëm midis një klase të vogël, por shumë të pasur, dhe asaj shumë më të madhe që ja duan të ikin ja tashmë kanë ikur!**

e saktë ka deklaruar që është vetëm në shërbim të popullit. Madje ndaj e mbështes dhe e sugjeroj si President, pasi mendoj se e mira e z. Reka është se duket i vetmi që e ka vendosur veten në funksion të popullit.

Duket se e di ekuacionin e pushtetit në shtetet demokratike, ku i pari vjen populli, ekuacion të cilin pushtetet në Maqedoninë e Veriut e kanë zgjidhur kaq keq, sa tashmë prej vitesh është krijuar një disbalans i jashtëzakonshëm midis një klase të vogël, por shumë të pasur, dhe asaj shumë më të madhe që ja duan të ikin ja tashmë kanë ikur! Nga mungesa e pushteteve të drejta në vendin tonë ka vetëm një ndarje të qartë, evidente si drita e diellit, dhe ajo nuk është etnike, as fetare, jo! Ndarja më e thellë dhe e vërtetë është Politikanë të Pasur-Popull i Varfër!


Ky është madje subjekt që meriton konspekt të veçantë nga të bërat që janë shkruar me lotët e njerëzve, mirëpo paturpësia vazhdon dhe kjo mu në zgjedhjet presidenciale! Këta politikanët boss-a që kanë zhveshur popullin nga xhepat dhe dinjiteti, tashmë e konsiderojnë si një instrument që mund ta luajnë si të duan, kur

të duan! Sipas këtyre, populli nuk është vetëm i varfër, por edhe budalla që Zoti i faltë e drejtësia foltë! Harrojnë se ky popull po i shkul si barishte të egra këto shëfat e politikës, se kopshtarët e huaj po marrin në duar lëndinat tona, dhe bimët helmuese që kanë vyshkur e mbytur qindra e mijëra fate, ngjyra, ëndrra, nuk i toleron! Fundi po afrohet dhe bëhet gati të trokasë në dyert e këtyre të pronarëve të gjërave të gabuara, pronarëve të popullit, të cilët në jetë të jetëve kanë pasur funde të hidhura!

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)



## FJALËKRYQI KLASIK





**HORIZONTALISHT:** 3. Pres grurin me drapër ose me kombajn; 5. Majë e mprehtë e një shkëmbi; 7. Bimë barishtore parazitare, 9. Gjinia; 10. Enë gjelle; 12. E rreme; 13. Ujdhesë në Itali; 15. Dëshmi e një personi se ka qenë në një vend tjetër në çastin e krimit; 16. Vepra muzikore dramatike; 18. Numër tek; 20. lloj gjysëm-majmuni; 23. Floriri; 24. Instrument muzikor (sh.); 26. Shënimi citimeve në fund të tekstit; 28. Shok (frëngj.); 29. Shufra hekuri për të pjekur mish; 30. Gypi i gjakut; 31. Lëndë për djegie apo ndriçim (sh.); 33. Dega e administratës që merret me llogaritje e të hollave; 41. Ithtar i monizmit; 42. Guxim; 43. Cipë e hollë në sy, perde; 44. Veturë gjermane (sh. pashq.); 47. Vepër e shkurtë letrare; 48. Autori ynë, Isaku; 49. Ulliri.

**VERTIKALISHT:** 1. Bujtinë; 2. Ish kryeministri shqiptar, Aleksandër; 3. Shund; 4. Gënjeshtër; 5. Embrioni i farës së bimëve; 6. Ndajfolje pyetëse; 8. Zë, rrok; 9. Gurua indian, Baba; 11. Burimi; 12. Sëmundje ngjitëse; 14. Internet Provider; 15. Këngëtarja amerikane, Frenklin; **17. Këngëtarja jonë në foto;** 18. Shtyp, trys; 19. Fat, kësmet; 21. Autori shqiptar, Butka; 22. Kryeministri shqiptar, Edi; 23. Shkëlqim i kadifesë; 24. Mal në kufirin e Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut; 25. Përemër vetor; 27. Futbollisti japonez, Juto; 30. Copë letre që tregon çmimin e një malli; 33. Pa dobi, pa ndonjë qëllim; 34. Aktori amerikan, Rajan; 35. Filloj; 36. Simboli i Tenesinit; 37. Trupat Ushtarakë (shkurt.); 38. E papërdorur; 39. Pjesë e tastierës; 40. Pjesë e trupit; 45. Shpend shtëpiak; 46. Lëndë minerale që del nga krateri vullkanik.

## Kakuro

5x5 dhe 6x6


Kakuroja është kombinim i fjalëkryqit dhe Sudokut. Në vend të shkronjave shënohen numra edhe atë prej 1 deri 9. Numrat nuk duhet të përsëriten as horizontalisht e as vertikalisht. Numrat brenda fushave duhet t'i japin shumat, të cilat janë dhënë në skajet e fushave që duhet të plotësohen.





## mini FJALËKRYQI

*Plotësojeni fjalëkryqin sipas figurave të dhëna!*



*Ndihmohuni këtrët t'i mbledhë të gjitha lajthitë dhe t'i çojë te druri, në fole!*



## 7 dallimet

*Gjejini dallimet të këto dy fotografi!*




## Fshehësira

*Ku fshehen figurat e dhëna?*




## SUDOKU "më i madh se"

Përdoren numrat prej 1 deri 9. Vlejnë rregullat e sudokut. Shenja ">" paraqet relacionin "është më i madh se".




## KENKEN

Përdoren numrat prej 1 deri 6. Vlejnë rregullat e sudokut. Numrat tregojnë rezultatin, ndërsa shenjat pranë numrit, operacionin matematikor.




## ARUKONE (Çiftimi)

Bashkoni me vija numrat e njëjtë (çiftet). Vijat nuk guxojnë të priten. Duhet të përfshihen të gjitha fushat!



## NONOGRAMI

Nxini fushat sipas numrave të dhëna. Numrat e dhëna e tregojnë numrin e fushave që duhet të nxihen.



## mini SKANDI me anagrame



Anagramet e mëposhtme japin dy vepra të autores sonë në foto.

**Anagrami 1**  
(vëllim poetik)  
**BURIMI**  
"STIL I LIRË"  
(I=U)

**Anagrami 2**  
(vëllim poetik)  
**BOLL E PËRSËRIT**  
ATË VES  
(-S)


MENSUR MAMUTI	AUTORJA JONË NË FOTO	BESËLDHËS	ANAGRAMI 1	OPERA E SHKURTE
ISH FUTBOLLISTI SHQIPTAR, ALTIN				
PARAARDHËS I YNI				
ISH FUTBOLLISTI YNË, MUSTAFI				
VEGËL NDËRTIMTARIE				
LEGJENDA E FUTBOLLIT KOSOVAR, FADIL				
ANAGRAMI 2	V	PASTRON ME UJE	MOTI IMPULSI	BELTEXHIU HASAN ZYKO
DETEKTIVI AMERIKAN, NES				SHKO RUMANIA
TANTALI		KRYEPROKURORJA E OKB-SË, DEL PONTE	FUNDËRRI, DRA(SH)	
PËRJETIMI NË GJUMË				USHTRIA MBRETERORE PO (FRËNGJ)
FOSFORI		HUMB PËRSËRI MELIHATE AJETI		
NËNA			LEGJENDË (SH. PASHQ.) KRAHAROR (LAT)	
MUNDËSI				UNIONI RINOR LIQEN NË TURQI
BELGIKA		QYMEZI, KOTECI (BISED.) FSHAT AFËR SHKUPIT		
QYTET NË SIRI				I ERRËT
QYTET NË PERU				KAMPIONI PËRËMËR VETOR
ZANORJA ETRETË DHE E PESTË		ENË E VOGËL QELQI PËR UJE OKSIGJENI		
KOHA E LIRË				ITALIA

## Sudoku

i lehtë	mesatar	i vështirë																																																																																																																																																																																													
<table border="1"> <tr><td></td><td></td><td>7</td><td>5</td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td>8</td><td></td><td></td><td>6</td><td></td><td></td><td>2</td></tr> <tr><td></td><td>7</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td>1</td></tr> <tr><td></td><td></td><td>4</td><td></td><td></td><td></td><td>5</td></tr> <tr><td>6</td><td></td><td>8</td><td></td><td></td><td></td><td>4</td></tr> <tr><td>4</td><td></td><td></td><td>2</td><td>7</td><td>3</td><td></td></tr> <tr><td></td><td>3</td><td></td><td>4</td><td>9</td><td>6</td><td></td></tr> <tr><td></td><td>2</td><td></td><td></td><td>4</td><td></td><td>7</td></tr> <tr><td></td><td>6</td><td>1</td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> </table>			7	5				8			6			2		7					1			4				5	6		8				4	4			2	7	3			3		4	9	6			2			4		7		6	1					<table border="1"> <tr><td></td><td></td><td>6</td><td>8</td><td>3</td><td></td><td></td></tr> <tr><td>5</td><td></td><td>7</td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td></td><td>1</td><td></td><td>5</td><td>2</td><td>7</td><td></td></tr> <tr><td></td><td>2</td><td>3</td><td>1</td><td></td><td>8</td><td>4</td></tr> <tr><td></td><td>7</td><td></td><td></td><td></td><td>3</td><td></td></tr> <tr><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td>1</td><td>2</td></tr> <tr><td></td><td></td><td></td><td>7</td><td>1</td><td></td><td></td></tr> <tr><td></td><td>5</td><td>4</td><td>2</td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td>8</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> </table>			6	8	3			5		7						1		5	2	7			2	3	1		8	4		7				3							1	2				7	1				5	4	2				8							<table border="1"> <tr><td>8</td><td>9</td><td>7</td><td>1</td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td></td><td>1</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td></td><td>2</td><td>5</td><td>8</td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td></td><td></td><td>3</td><td></td><td></td><td></td><td>5</td></tr> <tr><td></td><td></td><td>2</td><td>8</td><td></td><td></td><td>6</td></tr> <tr><td></td><td>6</td><td>3</td><td></td><td></td><td></td><td>2</td></tr> <tr><td></td><td>4</td><td></td><td>2</td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td></td><td>9</td><td>5</td><td></td><td></td><td></td><td>3</td></tr> <tr><td>6</td><td></td><td></td><td>9</td><td>4</td><td></td><td></td></tr> </table>	8	9	7	1					1							2	5	8						3				5			2	8			6		6	3				2		4		2					9	5				3	6			9	4		
		7	5																																																																																																																																																																																												
8			6			2																																																																																																																																																																																									
	7					1																																																																																																																																																																																									
		4				5																																																																																																																																																																																									
6		8				4																																																																																																																																																																																									
4			2	7	3																																																																																																																																																																																										
	3		4	9	6																																																																																																																																																																																										
	2			4		7																																																																																																																																																																																									
	6	1																																																																																																																																																																																													
		6	8	3																																																																																																																																																																																											
5		7																																																																																																																																																																																													
	1		5	2	7																																																																																																																																																																																										
	2	3	1		8	4																																																																																																																																																																																									
	7				3																																																																																																																																																																																										
					1	2																																																																																																																																																																																									
			7	1																																																																																																																																																																																											
	5	4	2																																																																																																																																																																																												
8																																																																																																																																																																																															
8	9	7	1																																																																																																																																																																																												
	1																																																																																																																																																																																														
	2	5	8																																																																																																																																																																																												
		3				5																																																																																																																																																																																									
		2	8			6																																																																																																																																																																																									
	6	3				2																																																																																																																																																																																									
	4		2																																																																																																																																																																																												
	9	5				3																																																																																																																																																																																									
6			9	4																																																																																																																																																																																											
<table border="1"> <tr><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td></td><td>2</td><td>4</td><td></td><td>6</td><td>5</td><td></td></tr> <tr><td>7</td><td>8</td><td>9</td><td></td><td></td><td>6</td><td>4</td></tr> <tr><td></td><td>2</td><td></td><td>4</td><td>1</td><td></td><td>8</td></tr> <tr><td></td><td></td><td></td><td>2</td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td></td><td>9</td><td>8</td><td>6</td><td></td><td></td><td>3</td></tr> <tr><td>1</td><td>3</td><td>4</td><td></td><td></td><td>8</td><td>5</td></tr> <tr><td></td><td></td><td>5</td><td>3</td><td>4</td><td>9</td><td></td></tr> <tr><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> </table>									2	4		6	5		7	8	9			6	4		2		4	1		8				2					9	8	6			3	1	3	4			8	5			5	3	4	9									<table border="1"> <tr><td>3</td><td></td><td></td><td>1</td><td></td><td></td><td>5</td></tr> <tr><td>4</td><td>2</td><td></td><td>8</td><td>6</td><td>7</td><td>1</td></tr> <tr><td></td><td></td><td>7</td><td></td><td></td><td>2</td><td></td></tr> <tr><td></td><td>7</td><td></td><td></td><td>4</td><td>6</td><td></td></tr> <tr><td>6</td><td></td><td>1</td><td>8</td><td></td><td></td><td>3</td></tr> <tr><td></td><td>8</td><td>7</td><td></td><td></td><td>1</td><td></td></tr> <tr><td></td><td></td><td>1</td><td></td><td></td><td>6</td><td></td></tr> <tr><td>7</td><td>3</td><td></td><td>6</td><td>1</td><td>2</td><td>9</td></tr> <tr><td>9</td><td></td><td></td><td>3</td><td></td><td></td><td>7</td></tr> </table>	3			1			5	4	2		8	6	7	1			7			2			7			4	6		6		1	8			3		8	7			1				1			6		7	3		6	1	2	9	9			3			7	<table border="1"> <tr><td>6</td><td></td><td></td><td></td><td>7</td><td>5</td><td></td></tr> <tr><td></td><td>9</td><td></td><td></td><td>3</td><td></td><td>2</td></tr> <tr><td></td><td></td><td></td><td></td><td>8</td><td>6</td><td></td></tr> <tr><td></td><td></td><td>1</td><td>5</td><td>7</td><td>9</td><td>4</td></tr> <tr><td></td><td>6</td><td></td><td></td><td>9</td><td>5</td><td></td></tr> <tr><td></td><td></td><td></td><td>3</td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td>1</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td>6</td></tr> <tr><td>7</td><td>5</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td></td><td>4</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> </table>	6				7	5			9			3		2					8	6				1	5	7	9	4		6			9	5					3				1						6	7	5							4					
	2	4		6	5																																																																																																																																																																																										
7	8	9			6	4																																																																																																																																																																																									
	2		4	1		8																																																																																																																																																																																									
			2																																																																																																																																																																																												
	9	8	6			3																																																																																																																																																																																									
1	3	4			8	5																																																																																																																																																																																									
		5	3	4	9																																																																																																																																																																																										
3			1			5																																																																																																																																																																																									
4	2		8	6	7	1																																																																																																																																																																																									
		7			2																																																																																																																																																																																										
	7			4	6																																																																																																																																																																																										
6		1	8			3																																																																																																																																																																																									
	8	7			1																																																																																																																																																																																										
		1			6																																																																																																																																																																																										
7	3		6	1	2	9																																																																																																																																																																																									
9			3			7																																																																																																																																																																																									
6				7	5																																																																																																																																																																																										
	9			3		2																																																																																																																																																																																									
				8	6																																																																																																																																																																																										
		1	5	7	9	4																																																																																																																																																																																									
	6			9	5																																																																																																																																																																																										
			3																																																																																																																																																																																												
1						6																																																																																																																																																																																									
7	5																																																																																																																																																																																														
	4																																																																																																																																																																																														



## KRIPTOGRAMI i kombinuar



1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	


1	2	3	4	5	6	5		7	5	8	9	6	1
10	5	11	9	12	3		7	5	13	3	12	3	8
9	14	5	11	5		15	5	6	5	11		13	16
7	5	6	5	12	17	5	2	3	8	1	13		6

6	9	8	5	12	1	13							
18	6			12	5	13	5	6					
19	20	1			14	9	15	5					
2	5	11	22			6	21	8					


B	SH	B	J	J	LL								K
K	J	LL	NJ	M								SH	NJ
LL		B	RR	DH	J	B	M						
B	M			C	NJ	K	J	DH					

B	M	B	J	RR	NJ	M	J	J		J	J	C	NJ
R	XH	LL	B		J	B	Y	DH	LL	J	RR	NJ	
B	K	DH	SH	J		J	B	C	B	M	J	J	TH
SH	B	SH	J	LL	J		LL	DH	SH	B	J	RR	B


Fjalëkryqi i parë plotësohet sipas rregullit "numri i njëjtë - shkronja e njëjtë", ndërsa fjalëkryqi i dytë sipas rregullit "shëno shkronjën fqinje". P.sh. në fushën ku është shkronja K, duhet të shënoni J ose L. Në fushat e hijezuara do të fitoni emrin dhe mbiemrin e autorit tonë në foto.




LABIRINTI




DALLIMET




FSHEHËSIRA




mini FJALËKRYQI




NONOGRAMI



KENKEN



SUDOKU



KRIPTOGRAMI i kombinuar

EROSIT  
KANAN  
Z

LLAVARIBI  
S I T

AVATARI  
KOTARI  
UR

EMAMIT  
PRASTET  
UR

ENDRA  
KARLA  
IK


ELIOT  
VITIT  
DARA

NEBIBI  
LIRI  
LALA


BOLE PËRSHËRTI  
Anagramt 2 (vetëm poezi)

BURMI  
STË I LIRË  
Anagramt 1 (vetëm poezi)

mini SKANDI me anagrame



ARKONE



FJALËKRYQI KLASIK

Disa komuna të Kosovës kanë kërkuar që mbyllja e kazinove të bëhet menjëherë. Në këto lokale shpeshherë po ka probleme dhe tash së fundi po vriten njerëzit. Tashmë kanë filluar procedurat që edhe të mbylljen të gjitha lojërat e fatit.

# PAS SHQIPËRISË, EDHE KOSOVA PARALAJMËRON MBYLLJEN E KAZINOVE



Bixhozi dhe lojërat e fatit vazhdojnë të frekuentohen shumë nga qytetarët në thuajse në gjithë botën. Edhe në Kosovë në qindra lokalet e licencuara të këtij lloj biznesi derdhet para e madhe nga qytetarët dhe shteti i Kosovës si taksë për këtë veprimtari merr miliona euro.

Republika e Shqipërisë e mbajti zotimin dhe me fillim të këtij viti i mbylli të gjitha lojërat e fatit. Përkundër këtij veprimi të shtetit shqiptar, ky biznes vazhdoi të lulëzojë në shtetin e Kosovës, duke i sjellë edhe leverdi në miliona në mbushjen e arkës.

Por, në këto lokale shpeshherë po ka probleme dhe tash së fundi po vriten njerëzit. Por, në këto lokale kohëve të fundit janë duke u vrarë edhe njerëzit. Vetëm brenda një jave në këto ambiente humbën jetën dy persona. Një u vra të mërkurën në Lipjan e një tjetër ditë më parë në Suharekë. Tash këto lokale po kërkohet që të mbylljen. E këto vrasje kanë ngjallur reagime

të shumta në Kosovë. Madje tashmë kanë filluar procedurat që edhe të mbylljen të gjitha lojërat e fatit.

Deputetët e Kuvendit të Kosovës, kanë thirrur seancë të jashtëzakonshme me kërkesë që Kuvendi të miratojë rezolutë lidhur me pezullimin e aktivitetit të kazinove dhe lojërave të fatit, si dhe plotësim-ndryshimin e ligjit ekzistues. Kurse, kryeministri i Kosovës Ramush Haradinaj ka përkrahur këtë seancë të thirrur.

“Përsëritës propozim rezolutën e 49 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, lidhur me pezullimin e aktivitetit të kazinove dhe lojërave të fatit dhe plotësim ndryshimin e ligjit përkatës”,

ka shkruar Haradinaj në Facebook.

Thotë madje se ekzekutivi e organet e drejtësisë, janë mobilizuar për të reaguar dhe për të parandaluar këto degradime nëpër lokale bastesh.

“Ditë më parë, si Kryeministër i vendit kam kërkuar iniciimin e procedurave të nevojshme brenda ekzekutivit, të cilat do të rezultojnë me mbylljen dhe pezullimin e aktivitetit të kazinove dhe lojërave të fatit. Përballë kësaj gjendjeje, ne nuk do të lejojmë që këto vende të jenë arenë e krimit dhe të marrin jetë njerëzish. Ekzekutivi dhe organet e sigurisë, tashmë janë mobilizuar për të reaguar dhe parandaluar degradimin e mëtejshëm”, përfundon Haradinaj.

Disa komuna të Kosovës kanë kërkuar që mbyllja e kazinove të bëhet menjëherë. Kryetari i komunës së Suharekës, Bali Muharremaj ka nisur një peticion për ta shfuqizuar Ligjin për lojërat e fatit dhe me këtë lokalet që e ofrojnë këtë veprimtari të mbylljen, pasi ditë më parë një qytetar u vra në njërin nga këto lokale.

Muharremaj ka treguar se nga dita e djeshme kur edhe nisi peticioni janë mbledhur 4000 nënshkrime kundër lojërave të fatit.

Në një postim në rrjetin social Facebook, Muharremaj ka shkruar se tani ka nisur të marrë mbështetjen e 40 të rinjve, me të cilët edhe foli për disa aktivitete që do të zhvillohen në të ardhmen.

“Deri më tani i kemi mbi 4000 nënshkrime për peticionin i cili kërkon shfuqizimin e Ligjit për Lojërat e Fatit. Sapo morra mbështetjen e mbi 40 të rinjve të cilët më vizituan dhe biseduam për shumë aktivitete të cilat do të ndodhin në të ardhmen”, ka shkruar Muharremaj. Kësaj iniciative i është bashkuar edhe kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmet. Mësohet se nënshkrimi i këtij peticioni do të bëhet në sheshin e qytetit në Lipjan. Edhe pse vrasjet ndodhën në këto dy komuna, iniciativës për

shfuqizimin e e Ligjit për Lojërat e Fatit po i bashkohen edhe kryetarët e komunave tjera të Kosovës. Bashkimi i menjëhershëm për këtë iniciativë të erdhi nga kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri. Iniciative po përkrahet edhe nga Komuna e Pejës. Pro kësaj iniciative ka dalë edhe Komuna e Gjakovës

Në Kosovë në qindra lokalet e licencuara të këtij lloj biznesi derdhet para e madhe nga qytetarët dhe shteti i Kosovës si taksë për këtë veprimtari merr miliona euro.

Vitin e kaluar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve janë regjistruar 21 biznese të reja, e në këtë vit janë regjistruar vetëm 7, kurse në 2016 janë regjistruar 17. Ndërsa më së shumti biznese të lojërave të fatit janë regjistruar në vitin 2011, gjithsejtë 58 të tilla.

Sipas të dhënave të zyrës së Informimit të MTI-së, keq nuk qëndrojnë as pronarët nga Shqipëria, të cilët posedojnë këso biznese në Kosovë. Janë 19 biznese të regjistruar me pronarë nga Shqipëria në Kosovë. Prej tyre 2 biznese me pronarë nga Shqipëria janë regjistruar sivjet, ndërsa vitin e kaluar 4.

Në Kosovë aktualisht janë lokale bastesh e me 1.463 automate bixhozi. (Monitor.al)

## SONDAZH I KE

### Gratë shqiptare kanë marrëdhëniet më të tensionuara me burrat në Europë



Marrëdhënia midis burrave dhe grave në shoqëria ka qenë në ndryshim të vazhdueshëm. Megjithatë, edhe pse gjërat po ndryshojnë, gratë ende luftojnë për barazi me burrat. Jo vetëm, në Shqipëri, por edhe në botë vijon që të ketë një hendek midis grave dhe burrave në pagë.

Gratë jo vetëm që nuk trajtohen si të barabarta në shoqëri, por ato i vlerësojnë edhe marrëdhëniet e tyre me burrat shumë të tensionuara.

Rreth 40% e të anketuarave në Anketën e cilësisë së Jetës të kryer nga Komisioni Evropian janë përgjigjur se perceptojnë se midis burrave dhe grave

ve në Shqipëri ka shumë tension. Kjo është përqindja më e lartë e shënuar në të gjithë vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe vendeve kandidatë për t'u anëtarësuar.

Të pyetur se si e vlerësojnë tensionin midis dy gjinive 40% janë përgjigjur se ka shumë tension dhe po aq e kanë vlerësuar si “disi të tensionuar”, vetëm 20% janë përgjigjur se midis dy gjinive nuk ka tension.


Ndërsa gratë janë ato që e perceptojnë më të lartë tensionin midis tyre dhe gjinisë tjetër. 49% e grave të pyetura e kanë vlerësuar marrëdhënien midis burrave dhe grave si shumë të

Pas Shqipërisë, vendi që ka përqindjen më të lartë të të anketuarve që janë përgjigjur se në marrëdhënien midis dy gjinive tensioni është i lartë është Turqia me 29% të të anketuarve

tensionuar, përkundrajt 32% të burrave.

Pas Shqipërisë, vendi që ka përqindjen më të lartë të të anketuarve që janë përgjigjur se në marrëdhënien midis dy gjinive tensioni është i lartë është Turqia me 29% të të anketuarve. Ndër vendet anëtare të Bashkimit Evropian, vetëm 9% e të anketuarve janë përgjigjur se perceptojnë shumë tension midis burrave dhe grave.

Anketa e Cilësisë së Jetës u krye në vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe kandidatëve potenciale ku u morr një kampion përfaqësues nga secili shtet, për të nxjerr më pas të dhëna të krahasueshme mbi cilësinë e jetës dhe marrëdhëniet sociale në Europë.



### Shultz : Duhet shumë vite që Shqipëria të futet në BE

Në një talk-show, për median gjermane ARD Tv, ish-kryetari i Parlamentit Evropian dhe deputeti i grupimit të Social-Demokratëve theksoi se Shqipëria nuk mund të futet në BE dhe se nuk ka krahasim mes Britanisë së Madhe dhe Shqipërisë. Në këtë mënyrë retorikat me sarkazëm të Edi Ramës, se largimi i Britanisë së Madhe do të mundësonte afrimin e Shqipërisë, ka marrë një përgjigje të prerëse nga Martin Shultz. Martin Schulz tha se: “Situata është pak depressive”. Schulz foli edhe kundër populistëve të krahut të djathtë dhe ishte i bindur se duan të fitojnë terren tek Parlamenti Evropian. Pozitat e tij të mërkurën mbrëma ishin tepër të dhunshme dhe emocionale, rrallë kjo në një studio gjermane. Disa herë ai duhej të përpiquej të qetësohej. Sidomos në një situatë, audiencia e tij tërhoqi vëmendjen kur foli për Shqipërinë. Sandra Maischberger, e cila diskutoi për çështjen e Brexit, i tha Schulz se: “Britanikët po largohen, po vjen Ballkani”? Roland Tichy reagoi me një buzëqeshje: “Një shkëmbim i madh, shkëmbim Shqipërinë për Britaninë e Madhe”. Si rezultat, Schulz reagoi duke thënë: “Jam lodhur nga demagogjiteti!” Nuk do të ketë hyrje shtesë në të ardhmen e afërt. Më pas, ish kandidati i kancelares ishte me të vërtetë i zemëruar. “Qeveria austriake është duke u kujdesur për këtë”, tha Schulz në drejtimin e anëtarit të Partisë së Lirisë Petra Steger. Kur ajo donte të përgjigjej, Schulz e ndërpreu atë dhe tha: “Nuk ka rëndësi”, dhe këmbënguli në përfundimin e tij.



Gratë gjithandej Zelandës së Re vunë shami në kokë të premtën për të treguar mbështetjen dhe respektin e tyre për komunitetin mysliman. Agjencia e lajmeve Reuters raporton se oficeret femra të policisë gjithashtu vendosën shami në kokë dhe nga një trëndafil të kuq në uniformat e tyre

Qytetarë të Zelandës së Re iu bashkuan faljes së Xhumasë në qytetin Kristçerç, në kujtim të 50 njerëzve të vrarë nga të shtënat në dy xhami, të premtën e kaluar. Në mesin e të tubuarve ishte edhe kryeministrja Jacinda Ardern.

"Zelanda e Re mban zi me ju. Ne jemi një", tha ajo.

Australiani Brenton Tarrant, 28 vjeç, i vetëpërkrahur si supremacist i bardhë, u akuzua për vrasjet në xhami. Ai do të paraqitet në gjykatë më 5 prill.

Kryeministrja Ardern mori vendim këtë javë që Zelanda e Re t'i ndalojë të gjitha llojet e armëve gjysmë-automatike dhe pushkët me shënjestrim.

"Historia jonë ndryshoi përgjithmonë. Tani, edhe ligjet tona do të ndryshojnë", tha Ardern.

Sulmuesi i xhamive e ka transmetuar drejtpërdrejt në Facebook aktin e tij. Të martën, Facebook tha se videoja e sulmuesit është shikuar

## ZELANDA E RE KUJTON VIKTIMAT E SULMIT NË XHAMI



më pak se 200 herë gjatë transmetimit të drejtpërdrejtë dhe rreth 4,000 herë përpara se është hequr nga Facebook-u.

Gratë gjithandej Zelandës së Re vunë shami në kokë të premtën për të treguar mbështetjen dhe respektin e tyre për komunitetin mysliman. Agjencia e lajmeve Reuters raporton se oficeret femra të policisë gjithashtu vendosën shami në kokë dhe nga një trëndafil të kuq në uniformat e tyre.

Më herët në një veprimtari në hapësirat përreth xhamisë ku ka

ndodhur sulmi fatal në Christchurch, imami Gamil Fouda iu drejtua turmës prej mijëra njerëzve që ishin mbledhur aty duke u thënë se "jemi zemërthyer, por nuk jemi të mposhtur". Ai u tha të tubuarve se "urrejtja do të zhbëhet dhe dashuria do të ngadhënjejë".

Imami falënderoi fqinjët "që hapën dyert e tyre për t'i shpëtuar njerëzit nga vrasësi", si dhe ata që ndaluan makinat e tyre për të ndihmuar. Imami Fouda gjithashtu shprehu mirënjohje për kryeministren e Zelandës së Re, Jacinda

Ardern, sepse siç tha ai, "ajo u ka qëndruar pranë familjeve të të prekurve dhe i ka nderuar ata duke vënë një shami të thjeshtë në kokë". Ai tha se "udhëheqja e kryeministres është një mësim për botën".

Para fjalimit të imamit, pati një thirrje publike për lutje në park që u transmetua në radio dhe televizion në të gjithë vendin. Dy minuta heshtje pasuan thirrjen për namaz, në kujtim të atyre që vdiqën në xhami. Zonja Ardern tha pas thirrjes për lutje se "Zelanda e Re vajton me ju, ne jemi një".



### SHBA ndalon përgatitjet për dërgesën e avionëve F-35 për Turqinë

Shtetet e Bashkuara së shpejti pritet që të pezullojnë përgatitjet për lëvizimin e avionëve luftarakë F-35 Turqisë, kane thanë zyrtarët amerikanë.

Një vendim i tillë pritet të jetë dhe sinjali më i fortë i Uashingtonit se Turqia, aleate e NATO-s, nuk mund të ketë njëkohësisht

aeroplanë të avancuar amerikanë dhe një sistem rus S-400 të mbrojtjes ajrore, raporton agjencia e lajmeve Reuters.

Ndërkohë SHBA nuk kanë arritura bindin Presidentin Recep

Tayyip Erdogan se blerja e sistemit rus të mbrojtjes ajrore do të kompromentonte sigurinë e avionëve luftarakë F-35.

"S-400 është një kompjuter, edhe F-35 është një kompjuter. Nuk mund të lidhësh kompjuterin tënd me atë të kundërshtarit dhe në fakt pikërisht kjo do të ndodhte, tha për agjencinë Reuters Katie Wheelbarger, ndihmëse sekretare e mbrojtjes për sigurinë ndërkombëtare.

Megjithatë ende nuk është marrë ndonjë vendim, zyrtarët e SHBA.

Edhe pse Shtetet e Bashkuara shpresojnë se Turqia ende mund të heqë dorë nga sistemi rus S-400, ekspertët thonë se zoti Erdogan ndoshta e ka futur veten në një rrugë pa kthim me retorikën e tij. Ai ka thënë disa herë se nuk do të ndryshojë kurs lidhur me sistemin S-400.

## SHBA drejt njohjes së sovranitetit izraelit mbi Lartësitë Golan

Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump tha se është koha që SHBA-ja të njohë sovranitetin e Izraelit në Rrafshnaltën e Golanit.

Izraeli e mori nën kontroll këtë territor nga Siria pas luftës së vitit 1967. Siria vazhdimisht ka kërkuar të rikthejë sovranitetin mbi rajonin.

Përmes një postimi në Twitter,



presidenti Trump deklaroi se Rrafshnaltja e Golanit ka rëndësi strategjike dhe të sigurisë për Izraelin

dhe rajonin.

"Pas 52 vitesh është koha që Shtetet e Bashkuara të njohin plotësisht sovranitetin e Izraelit mbi Rrafshnaltën e Golanit, që është e një rëndësie strategjike dhe të sigurisë për Izraelin dhe stabilitetin rajonal", shkroi presidenti amerikan, Donald Trump. Kryeministri izraelit, Benjamin Netanyahu, menjëherë reagoi duke falenderuar presidentin Donald Trump.

"Në një kohë kur Irani kërkon të përdorë Sirinë si një platformë për të shkatërruar Izraelin, Presidenti Trump pranon me guxim sovranitetin izraelit mbi Rrafshnaltën e Golanit" tha Netanyahu.

Izraeli ushtron administrimin në Rrafshnaltën e Golanit që nga viti 1981 por qeveritë tjera nuk e njohin këtë akt.

## Të luftojmë islamofobinë siç bëjmë me antisemitizmin

"Në këto kohë po përballemi me një valë të gjerë islamofobie dhe urrejtjeje ndaj myslimanëve", tha Erdogan

Presidenti turk, Recep Tayyip Erdogan bëri thirrje këtë të premte për një luftë globale kundër islamofobisë në rritje, ngjashëm me antisemitizmin pas holokaustit, pas sulmeve vdekjeprurëse në dy xhami të Zelandës së Re.

Udhëheqësi turk e ka prezantuar rastin e sulmeve në xhami, nga i ashtuquajturit supremacist i bardhë që vrau 50 vetë, si një sulm më të gjerë ndaj Islamit dhe kërkon nga Perëndimi që të bëjë më shumë kundër ndienjave antimuslimane.

"Ashtu siç njerëzia luftoi kundër antisemitizmit pas fatke-

qësisë së holokaustit, po me të njëjtën vendosmëri duhet të luftojmë edhe kundër islamofobisë në rritje", tha Erdogan gjatë një takimi të ministrave nga Organizata për Bashkëpunimin Islamik në Stamboll. "Në këto kohë po përballemi me një valë të gjerë islamofobie dhe urrejtjeje ndaj myslimanëve", tha ai.

Erdogani tha se grupet neonaziste të ekstremit të djathtë duhen trajtuar si terroristë, në të njëjtën shkallë me xhihadistët e Shtetit Islamik.

Më 15 mars, agresori austrian Brenton Tarrant vrau 50 burra, gra

e fëmijë, viktime këta të grupmoshave nga 3 në 77 vjeç, e la edhe dhjetëra të tjerë në një sulm që shkaktoi indinjatë globale. Ai transmetoi drejtpërdrejt pjesën kryesore të sulmit, teksa kishte përhapur në rrjetet sociale edhe manifestin e sulmit, duke pretenduar se ajo që po bënte ishte një goditje ndaj myslimanëve "push-tues".

Qeveria e Zelandës së Re garantoj sërish të premtën myslimanët që jetojnë në vend se "do të jetë të qetë dhe të sigurt" pavarësisht sulmeve vdekjeprurëse në Christchurch.



Erdogani, i cili po bën fushatë për zgjedhjet lokale këtë muaj, ka irrituar Zelandën e Re teksa ka shfaqur vazhdimisht videon e bërë nga agresori, një austrian i cili është arrestuar prej asaj dite. Por, presidenti turk ka irrituar edhe Australinë, me komentet mbi austrialianët antimuslimanë që u kthyen

me "arkivole" si gjyshërit e tyre në Gallipoli, një nga betejat e Luftës së Parë Botërore.

Megjithatë, ministri i Jashtëm turk Mevlut Cavusoglu lavdëroi autoritetet neozelandeze të premtën për reagimin e tyre dhe i falënderoi për "mesazhet e sinqerta të solidaritetit". / Top Channel

Mathias Enard, Meik Wiking dhe Paulo Coelho ishin tre autorët e huaj më të lexuar nga kosovarët gjatë vitit 2018, me veprat "Busull", "Hygge" dhe "Alkimisti". Ndërsa nga autorët shqiptarë më i kërkuari vazhdon të jetë Ismail Kadare, me veprën "Kur sunduesit grinden"

Kjo në bazë të kërkesave që kishin nga lexuesit e tyre libraritë "Buzuku", "Dukagjini" dhe Biblioteka "Hivzi Sulejmani". Ndërkaq jo pak vëmendje morën titujt e rinj, të cilët shumë shpejt gjenden në raftet e librarive në vend, pasi që kërkesa për ta mbetet e madhe.

Në mesin e librave më të kërkuar ishin edhe ata në gjuhën angleze. Derisa lexuesit më të interesuar për librin del të jenë ata të moshës mesatare 25-40 vjet, por pa anashkaluar edhe interesimin e grupmoshave të tjera.

Besian Zeneli nga libreria "Buzuku", thotë se viti që lamë pas ka pasur prurje të mëdha të titujve. Teksa thotë se është pozitive se si nga viti në vit po rriten kërkesat e qytetarëve për literaturën për fëmijë.

"Mathias Enard me tre romanet e tij, 'Busull', 'Zonë', dhe 'Qitje e përsosur', kanë qenë tre romanet më të kërkuar i përket letërsisë. Për të vazhduar më pastaj me 'Inteligjenca emocionale' që ka qenë një titull jashtëzakonisht interesant... Nëse vazhdojmë me autorin shqiptar që ka qenë më i kërkuari, padyshim që është Kadare dhe Albatros Rexhaj. Kadare me romanin e fundit 'Kur sunduesit grindeshin', po ashtu edhe Alba-

AUTORËT MË TË LEXUAR NË KOSOVË

# KADAREJA MË I PREFERUARI



tros Rexhaj me romanin 'Kthimi', tha ai, raporton Kosovapress.

Kurse Iliriana Hasaj nga libreria "Dukagjini", ka thënë për Kosova-Press, se është e vështirë të bëhet një renditje e librave më të kërkuar, pasi që kërkesat e lexuesve kosovarë për librin çdoherë e më shumë po rriten.

Sipas saj, kjo ka bërë që edhe librat në gjuhën angleze, konkretisht titujt e vonshëm, depërtojnë menjëherë tek lexuesit e apasionuar në vend.

"Në gjuhën shqipe e kisha veçuar, ka qenë libri 'Hygge', me këshilla se si danezët e bëjnë një jetë më të mirë. Ka qenë libri nga Hentem Ramadani 'Shëndeti dhe sukcesi përmes meditimit'. Tash së voni, edhe pse është botuar tash vonë, jashtëzakonisht shumë ka pasur kërkesë dhe është shitë libri 'Presidenti është zhdukur', nga presidenti Bill Clinton dhe James Patterson. Ky ishte romani i parë i Bill Clinton-it, sepse ai më parë kishte

shkruar biografi dhe është shumë interesant dhe duhet me e cekë që tash vetëm sa është botuar libri 'Becoming' nga Michelle Obama, biografia e saj ka qenë e jashtëzakonshme", tregoi ajo.

Ajo tregon edhe për kërkesat konstante të lexuesve në vend, që nuk i lënë asnjëherë në hije disa autorë dhe vepra, pavarësisht titujve të ri. E ndër më të preferuarit siç thotë ajo, mbeten librat klasik.

Ndërsa sa i përket autorëve shqiptarë, Hasaj thotë se Kadare mbetet i pavdekshëm, me ç'rast rrëfen se si vetëm brenda dy ditëve janë shitur të gjithë ekzemplarët e librit të tij të fundit "Kur sunduesit grinden".

"Ato që ndoshta nuk vdesin kurë, përveç librave klasik, kisha me veçu autorin e njohur bashkëkohor japonez Haruki Murakami, librat e të cilit tek ne, sidomos tek të rinjtë, po lexohen shumë. Vepra e tij më e shitur

vazhdimisht, vit pas viti është 'Pyl-li norvegjez' si dhe 'Kafka në breg'. Të njëjtit autor, sapo i është përkthyer edhe një libër në gjuhën shqipe. Gjithashtu, nga Rhonda Byrne është 'Sekreti', një libër i cili na flet për fuqinë e mendimeve tona se si çdo gjë që mendojmë edhe besojmë se do të bëhet, ato realizohen. 'Sekreti' vitin e kaluar i është shtuar 'Fuqia' dhe 'Magjia', u shpreh ajo.

E drejtori i bibliotekës "Hivzi Sulejmani", Munish Hyseni thotë se gjatë vitit që e lamë pas, mbi 100 mijë libra janë tërhequr për lexim nga anëtarët e bibliotekës.

Në një prononcim për Kosova-Press, ai thotë se në biblioteka ndër librat më të kërkuar mbeten lekturat shkollore, ndërsa jashtë kësaj, tregon se cilat ishin romanet tjera më të preferuara.

"Tek pjesa e fëmijëve dhe të rinjve, librat më të lexuara janë të Williamsit, është një komplet prej disa vëllimesh. Ndërsa tek të rriturit, po ashtu prinë letërsia e të huajve, apo letërsia botërore siç e quajmë ne, që është Coelho njëri prej më të lexuarve, Dan Brown, dhe ajo që vazhdon me vite të tëra, është Daniel Steel dhe Nicola Sparks. Nga letërsia shqipe, edhe më tutje Ismail Kadare është më i kërkuari. Por, është një diçka që përdodh këto dy vitet e fundit, në mënyrë të veçantë me një autore, një mjeke, specialiste, Brunilda Zilami. Është një prej autoreve që këto dy vite kërkohet shumë në përgjithësi", tha ai.

Krahas kësaj, Hyseni tregon se janë edhe librat e vjetër që vazhdojnë të zgjojnë interesim tek lexuesit kosovarë. E ndër ta thotë se më i kërkuari mbetet Shekspiri.

E se cilët ishin librat që zgjuan kureshtjen e lexuesve për vitin 2018 tregojnë edhe preferencat e lexuesve të bibliotekës "Hivzi Sulejmani" në Prishtinë.

Kështu, Fjolla Krasniqi, e cila lexon me ëndje literaturën botërore, tregon se nuk i lë anash autorët shqiptarë. E pasionuar pas librit, ajo nuk e ka vështirë të tregojë disa nga librat që i lanë më shumë përshtypje në vitin që e lamë pas.

"Fillimisht, po e përmendi 'Martin Eden' që është e Jack London-it, më ka lënë shumë përshtypje. Por, ka edhe libra të tjerë, për shembull Dan Brown që është 'Diabolus' dhe librat tjerë që i ka, për shembull 'Kodi i Da Vinçit'. Mandej, edhe të Ismail Kadaresë si 'Prilli i thyer' e kështu me radhë. Po më shumë preferoj letërsinë botërore", tha ajo.

Ndërsa studentin Krenar Tërstena, dinamika e mësimëve e mbanë më afër me literaturën shkencore, pasi që vijon Fakultetin e Veterinarisë.

Por, në kohën e lirë, kryesisht pas afatit të provimeve, ai thotë se relaksohet duke lexuar romane.

"Fantazi, mister, për vete i pëlqej më shumë këto dy lloje të romaneve... Ndër librat e preferuar që i kam lexuar janë të autorit Dan Brown, titulli i librit është 'Kodi i Da Vinçit', tregoi ai.

Për kontributin e veçantë në zhvillimin e kulturës, në kultivimin e traditave atdhetare, të gjuhës, të historisë, si dhe përkushtimin për arritjen e aspiratave kombëtare, Shoqata "Tradita" në këtë manifestim u ndau MIRËNJOHJE Gjumnazit "7 Marsi" – Tetovë dhe PEN Qendrës nga Republika e Shqipërisë

Shoqata për kulturë dhe art "Tradita" dhe Gjumnazi "7 Marsi" – Tetovë, me rastin e 21 marsit – Ditës Botërore të Poezisë e organizuan Edicionin III me radhë të manifestimit letrar ndërkombëtar "Shtigje poetike". Në këtë veprimtari kulturore u theksua se me organizimin e këtij manifestimi realizohet një nga projektet e njohura të kulturës sonë, duke përbushur në këtë mënyrë një detyrim që art-

## TETOVË, MBAHET EDICIONI III I "SHTIGJEVE POETIKE"



dashësve të qytetit rrëzë Sharrit t'u ofrohet sa më tepër veprimtari letrare. Organizatorët vlerësuan njëherazi se këto ngjarje ngërthejnë në vetvete simbolikën e ngritjes së përbashkët në lëmin e arsimit, shkencës, kulturës, artit, si dhe në fushën e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të arsimit dhe subjekteve të ndryshme kulturore.

"Letërsia shqiptare, në veçanti ajo gojore është e pasur me lirika

të bukura që shpeshherë kanë qenë frymëzim edhe për poetët e krijimtarisë artistike. Ne të gjithë i kemi të lexuara dhe i kemi të njohura vargjet poetike të Naim, të Pjetër Zarishit, të Filip Shirokës, të Çajupit, të Asdrenit, të De Radës, të Zef Sermbes etj. Në shekullin e kaluar, në letërsinë shqiptare paraqiten emra eminentë, si: Ndre Mjeda, Gjergj Fishta, Fan Noli, Ernest Koliqi, Lasgush Poradeci, etj, pa i harruar edhe poetët dhe krijimet e

tyre që kanë pasur dhe që vazhdojnë të kenë ndikim të jashtëzakonshëm te lexuesi shqiptar dhe jo vetëm, siç janë: Dritëro Agolli, Ismail Kadare, Fatos Arapi, Bardhyl Londo, Dhori Qiriazhi, Visar Zhiti, Esad Mekuli, Ali Podrimja dhe shumë e shumë të tjerë", theksoi në fjalën e tij kryetari i Shoqatës "Tradita".

Presidentja e Qendrës PEN nga Shqipëria, Entela Klasi, u shpreh se merr pjesë në këtë ngjarje letrare-artistike.

"Temat për të cilat ne shkruajmë jemi ne. Me këtë dua të them se kur shkruajmë ne krijojmë qenie veten. Thënë shkurt: shkruajmë njeriun në thellësitë dhe dimensionet duke dëshmuar njeriun. Kjo nuk mund të kryhet pa gjuhën, pa gjuhën e gjithë secilit autor, sepse ne jemi lindur me gjuhë, ajo që quhet gjuha e nënës, në të cilën njeriu

mendon dhe shkruan gjithçka që shqisa ka parë, gjithçka që intelekt i ka përmbledhur, gjithçka që duhet thënë", theksoi Entela Kasi.

Në Edicionin III të manifestimit letrar ndërkombëtar "Shtigje poetike" u mbajt edhe orë letrare në të cilën morën pjesë emra të njohur poetësh dhe shkrimtarësh nga Tetova e më gjerë, Klubi letrar i nxënësve të Gjumnazit "7 Marsi", u prezantua një program i pasur artistik i realizuar nga nxënësit e kësaj shkolle si dhe nga studentët e programit muzikor të Fakultetit të Arteve të Universitetit të Tetovës.

Për kontributin e veçantë në zhvillimin e kulturës, në kultivimin e traditave atdhetare, të gjuhës, të historisë, si dhe përkushtimin për arritjen e aspiratave kombëtare, Shoqata "Tradita" në këtë manifestim u ndau MIRËNJOHJE Gjumnazit "7 Marsi" - Tetovë dhe PEN Qendrës nga Republika e Shqipërisë. (U.H)





## Challandes: Të qëndrojmë me këmbë në tokë

Danimarka erdhi për t'u stërvitur në Kosovë, por ndeshja miqësore doli të jetë një stërvitje mjaftë e vështirë për ta sepse në stadiumin "Fadil Vokrri", Dardanët ishin duke fituar 2-1 deri në minutën e fundit, para se Pierre-Emile Hojbjerg të shënojë për 2-2 në minutën e 91'. Bernard Challandes, trajneri i Kosovës, është shprehur shumë i lumtur për paraqitjen fantastike të Kosovës, pavarësisht golit që pranuan në fund të ndeshje. "Mendoj që Kosova mundet me udhëheq dhe skuadrat tjera duhet të kenë respekt për Kosovën por gjithashtu duhet të qëndrojmë me këmbë në tokë duhet të punojmë dhe të mësojmë sepse jemi në një process mësimi", tha ai. "Në Nations League kemi mësuar se nuk duhet të jemi të frikësuar, por duhet të punojmë së bashku dhe të bëjmë shumë gjëra së bashku. Duhet të gjejmë një balancë mes modestisë dhe besimit", deklaroi Challandes. Pas ndeshjes trajneri i Danimarkës, Age Hareide pohoi se kjo ishte një ndeshje mjaft e vështirë dhe se nuk e kishte pritur një gjë të tillë. "Mendoj që ishte një lloj thirrje zgjimi për të tërë neve, sepse nuk bën të dalim në fushë të pa përgatitur 100% për ndeshjen. Mirëpo mirë që kjo na ndodhi sonte, e jo në ndonjë ndeshje kualifikuese. E mira e së mirës është që lojtarët nuk deshën të humbim këtë ndeshje dhe ashtu ndodhi arritjen ta barazonin rezultatin", u shpreh trajneri i Danimarkës. "Dua të them përsëri se ka qenë një ndeshje e mirë stërvitore. Kam thënë edhe dje, që Kosova ka lojtarë të mirë, ka luajtur mirë në të gjitha pozicionet. Në Evropë nuk duhet të lejohet një gjë e tillë. Kemi pranuar 2 gola sa kemi pranuar tërë vitin e kaluar. Edhe njëherë dua të them se Kosova ka luajtur mjaftë mirë sonte", shtoi ai. Christian Eriksen është befasuar nga paraqitja e Kosovës në stadiumin "Fadil Vokrri", që për pak e mposhti skuadrën e 10 në renditjen e FIFA-s. "Pritjet tona, sikur të gjithë botës së jashtme ishin që ne do të fitonim me lehtësi, por kur nuk mund të bënim lojë tonë në pjesë të mëdha të ndeshjes, atëherë luani një barazim kundër një vendi të tillë të vogël që ka futbollistë të mirë kur ata marrin kohë dhe hapësirë", deklaroi Eriksen që hyri nga stoli dhe shënoi nga penalltia për 1-1. "Ishte më rëndësi të mos humbim, ndjenja që nuk kemi humbur duke marrë parasysh mbarëvajtjen e lojës ka shumë rëndësi. Nëse do kishim humbur do ishte goditje e madhe, edhe barazimi është hap prapa për ne, por në një mënyrë jemi të kënaqur me barazim duke marrë parasysh se si shkoi ndeshja", shtoi ai. Eriksen, që aktivizohet te Tottenhami, tha ndër të tjera se do t'i njoftojë anglezët për Kombëtaren e fortë që ka krijuar Kosova. "Kosova është një ekip shumë i vështirë për t'u mposhtur, do t'ju tregoj anglezeve që Kosova këtu është e rrezikshme dhe kualifikimi për Euro 2020 nuk do të jetë i lehtë", deklaroi Eriksen.

MAQEDONIA E VERIUT I NIS ME FITORET ELIMINATORE PËR KE 2020

# ANGELOVSKI: I GËZUAR PËR PIKËT, NA PRET TAKIMI ME SLOVENINË



Koha Fisnik NUHIU

Shkup, 22 mars - Përfaqësuesja e Maqedonisë së Veriut në futboll i ka nisur me fitore eliminatorët e Kampionatit Evropian të vitit 2020. Falë dy golave të Elif Elmas dhe një të Ezgjan Alioski, reprezentacioni i Maqedonisë së Veriut arriti që të shënon fitore ndaj Letonisë me rezultatin 3:1 dhe të arkëton tre pikët e para në grup. Golin e vetëm për mysafirët e shënoi Vjaceslavs Isajevs në minutën e 85 të takimit. Lajmi i keq për Igor Angelovskin është lëndimi i Ferhan Hasanit në mesin e pjesës së parë. Ndeshja e radhës e Maqedonisë do të jetë më 24 mars në Lubjanë, kundër Sllovenisë. Trajneri i Maqedonisë së Veriut në futboll, Igor Angelovski, nuk fshehu gëzimin për fitoren dhe lojë e treguar në pjesën e parë, në fitoren 3-1 ndaj Letonisë, në fillim të eliminatorëve të Euro 2020. "Realizuar atë që e paralajmëruam, krijuam raste të mëdha dhe duhej edhe më herët të zgjedhin çështjen e fituesit. Nuk duhet të ketë eufori dhe duhet të mendojmë për ndeshjen e dytë gjatë ditës së diel. Goran Pandevi meritoi që ti urohet me fitore dhe jam i kënaqur që kam punë me një kapiten të tillë. I dëshiroj të gjithë futbollistëve që të arrijnë jubile të tillë. Elifin e njoh shumë mirë dhe e di çfarë kualiteti posedon dhe duhet ti uroj për 2 golat. Ishte me të vërtetë mjaft mirë që të shohim

"Realizuar atë që e paralajmëruam, krijuam raste të mëdha dhe duhej edhe më herët të zgjedhin çështjen e fituesit. Nuk duhet të ketë eufori dhe duhet të mendojmë për ndeshjen e dytë gjatë ditës së diel", deklaroi Angelovski

lojë tonë në pjesën e parë dhe më vjen keq që nuk shënuam golin e tretë në këtë periudhë kohore. Por duhet të përmirësohemi më shumë në efikasitetin e lojës, sepse krijuam shumë raste për ato dy gola, ndërsa në takimet e tjera ndoshta nuk do të kemi aq shumë mundësi, prandaj duhet të shfrytëzojmë secilën prej tyre", deklaroi Angelovski. Në këtë sfidë kapiteni Goran Pandev regjistroi ndeshjen e 100 në fanellën e Maqedonisë së Veriut ndërsa para fillimit të takimit morri një çmim simbolit nga UEFA. "E rëndësishme është që i nisëm me fitore eliminatorët. Tre pikët kanë shumë vlerë, edhe pse në pikë të parë duket se shumë lehtë arritëm deri te fitorja. Jam i lumtur për ndeshjen e 100 me fanellën e Maqedonisë së Veriut, po ashtu i lumtur edhe me Elifin si dhe Ezgjanin. Kemi në ekip shumë të mirë dhe në Slloveni shkojmë me plotë optimizëm. Shpresoj se do të arrijmë të marrim rezultatin që ne e kërkojmë", theksoi Goran Pandev. Pas takimit ka folur edhe shënuesi i golit të parë në sfidën ndaj Letonisë, Ezgjan Alioski, i cili potencoi se kjo fitore shkon për kapitenin, Goran Pandev si dhe për të gjithë sportdashësit e Maqedonisë. "Kemi arritur të

shënojmë fitore, gjithçka shkoi shumë mirë. Fitoren ja dedikojmë Pandevit dhe gjithë Maqedonisë së Veriut. Rezultati mund të ishte edhe më i lartë, mirëpo pikët mbeten tek ne. Është kënaqësi të luash me këtë ekip. Por tani neve na ngelet të koncentrohemi për sfidën e radhës ndaj Sllovenisë. E dimë që ata janë një skuadër e mirë individuale, mirëpo ne jemi të fortë dhe të bashkuar si ekip, do të luftojmë që edhe në Slloveni të marrim rezultat pozitiv", ka theksuar Alioski. Nga ana tjetër trajneri mysafirë, Slavisha Stojanoviç ka theksuar se ekipi i tij nuk duroi presionin në fillim të ndeshjes dhe se po të kishte mundësi do të bënte 6 zëvendësime në pushim mes dy pjesëve. "Kemi zhvilluar një pjesë të parë shumë të keqe, ndërsa Maqedonia arriti shumë shpejt të kishte epërsi 2-0, ndërsa ne kishim rënie në planin fizik dhe në mënyrë naive humbëm takimin. Në fund të ndeshjes shënuam gol me çka kishim shpresë se mund të mbetemi të pamposhtu, mirëpo kjo nuk ishte e mjaftueshme. Në fund të pjesës së parë dëshiroja që të bëj 6 ndërrime, mirëpo e dini se nuk mund të bëj një gjë të tillë", deklaroi trajneri i Letonisë, Stojanoviç.

## FUTSAL

# SHKUPI MARSHON DREJT TITULLIT

Shkup, 22 mars - Skuadra e futsalit Shkupi të enjten në mbrëmje shënoi një ndër fitoret më të mëdha në këtë fazë, duke mundur Astibon nga Shtipi në terren mysafirë me rezultatin 7:2. Edhe pse për Shkupi kjo konsiderohej si një ndër ndeshjet më të vështira në fund ekipi nga Shkupi arriti të marr një fitore të lehtë. Në pjesën e parë skuadra e Futsal Shkupi arriti që të shkon në pushim me një gol në avantazh 1:2. Ndërkaq, pjesën e dytë gjithçka fliste në anën e Shkupi, të cilët arritën që në portën e portierit nikoqir të shënojnë edhe plot 5 gola. Ismet Ceka nga radhët e Shkupit shënoi 4 gola, ndërsa nga një gol regjistruan edhe



Taulant Ismaili, Erkan Shabani dhe Eroll Dalip. Me këtë fitore Futsal Shkupi tashmë numëron 60 pikë, 10 më shumë se Velezi,

skuadër kjo që ndeshjen e katërt të fazës plej-of do ta zhvillojë të dielën kundër Zhelezarecit.



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT  
KOMUNA E ZHELINËS

Në bazë të nenit 21 nga Ligji për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.199/2014,42/ 2015, 44/2015, 193/2015, 31/2016, 163/16, 64/20018 dhe 168/2018), Kryetari i Komunës së Zhelinës, e lëshon këtë:

KOMUNIKATË

Njoftohen qytetarët dhe personat juridik në territorin e komunës së Zhelinës se shpallet:  
**Thirrje publike për miratimin e iniciativave të përpunimit të planeve Urbanistike**

Thirrja publike shpallet në pajtim me nenin 21 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 199/14,42/ 2015, 44/2015, 193/2015,31/2016,163/16,64/20018 dhe 168/2018), në kuartalin e parë të vitit 2019.

- **Gjatë periudhës prej 30 ditësh**, të gjithë personat e interesuar fizik dhe juridik duhet të dorëzojnë iniciativa për përpunimin e planeve Urbanistike sipas **nenit 7 paragrafi 1, pika 2 alineja 3 dhe 4** të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik.

- **Objekt i iniciativave** mund të jetë miratimi i Planit të ri Urbanistik ose ndryshim dhe plotësim i Planit Urbanistik ekzistues me propozim konkret nga parashtruesi i iniciativës.

- **Thirrja publike do të zgjas nga 25.03.2019 deri më 25.04.2019, respektivisht 30 ditë**, duke llogaritur nga publikimi në shtypin ditor.

- **Thirrja publike do të shpallet** në ueb faqen e komunës së Zhelinës [zhelina.gov.mk](http://zhelina.gov.mk), në tabelën shpallëse të komunës, në sistemin informativ e-urbanizëm dhe nëpërmjet shpalljes në fletoren zyrtare të komunës.

- **Personat e interesuar fizik dhe juridik**, iniciativat e tyre t'i dorëzojnë në formë të shkruar nëpërmjet arkivit të komunës së Zhelinës, ose në formë elektronike përmes sistemit informativ e-urbanizëm në afatin e caktuar.

- **Për të gjitha iniciativat e pranuar**, parashtruesit do të informohen me shkrim ose në formë elektronike, nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm në afat prej **15 ditësh** nga kalimi i afatit të parashtrimit të iniciativave.

- **Iniciativat e pranuar** të thirrjes publike, do të inkorporohen në Programin për përpunim të planeve Urbanistike në territorin e komunës së Zhelinës për vitin 2019.

- **Mjetet e iniciativave** të pranuar për përpunimin e dokumentacionit të nevojshëm, duhet të sigurohen nga parashtruesit e iniciativave-personat fizik ose juridik.

KOMUNA E ZHELINËS

Kryetari  
Mr. Blerim Sejdi

KOMUNA ÇUÇER - SANDEVË

Kryetari i Komunës së Çuçer - Sandevë

Në bazë të nenit 46 paragrafi 9 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16, 163/16, 64/18 dhe 168/18), Kryetari i Komunës së Çuçer Sandevës, publikon

LAJMËRIM

Informohen qytetarët dhe subjektet juridike nga Komuna e Çuçer Sandevës se Kryetari i Komunës së Çuçer Sandevës ka sjellë vendim për organizim të:

1. Prezantimit publik dhe anketës publike në lidhje me Dokumentacionin lokal planor urbanistik për ndërtim të objektit për qëllim A4 të pjesë nga PK 3389/1 dhe PK 3389/2, KK Gluvo Brazda, Komuna e Çuçer Sandevës.
2. Prezantimi publik i DLPU do të mbahet më datë 27.03.2019 (e mërkurë) me fillim në ora 10:00, në sallën e madhe të Komunës së Çuçer Sandevës
3. Anketa publike për DLPU do të zgjasë 5 ditë pune nga dita e publikimit në mjetet e informimit.

Përfshirja për të cilën organizohet anketë publike dhe prezantim publik për Dokumentacionin lokal planor urbanistik për ndërtim të objektit për qëllim A4 - depo të pjesë nga PK 3389/1 dhe PK 3389/2, KK Gluvo Brazda, Komuna e Çuçer Sandevës, gjendet në pjesën jugore të KK Gluvo Brazda dhe në mënyrë administrative i takon Komunës së Çuçer Sandevës, madhësia e përfshirjes është 0,58 ha.

Dokumentet planore do të ekspozohen në hapësirat e Komunës së Çuçer Sandevës në f. Kuçevishite. Qytetarët dhe subjektet juridike të interesuar në afatin e paraparë mund të parashtrorjnë vërejtjet, mendimet dhe propozimet e tyre përmes postës ose përmes arkivit të komunës, çdo ditë pune prej ora 09:00 deri në ora 15:00.

KOMUNA E ÇUÇER SANDEVËS  
KRYETARI I KOMUNËS  
Jovan Pejkovski

KOMUNA ÇUÇER - SANDEVË

Kryetari i Komunës së Çuçer - Sandevë

Në bazë të nenit 46 paragrafi 9 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16, 163/16, 64/18 dhe 168/18), Kryetari i Komunës së Çuçer Sandevës, publikon

LAJMËRIM

Informohen qytetarët dhe subjektet juridike nga Komuna e Çuçer Sandevës se Kryetari i Komunës së Çuçer Sandevës ka sjellë vendim për organizim të:

1. Prezantimit publik dhe anketës publike në lidhje me Dokumentacionin lokal planor urbanistik për objekte me qëllim G4 - depo të pjesë nga PK 5815/1, pjesë nga PK 5816 dhe pjesë nga PK 5817/1, KK Kuçevishite, Komuna e Çuçer Sandevës.
2. Prezantimi publik i DLPU do të mbahet më datë 27.03.2019 (e mërkurë) me fillim në ora 12:00, në sallën e madhe të Komunës së Çuçer Sandevës
3. Anketa publike për DLPU do të zgjasë 5 ditë pune nga dita e publikimit në mjetet e informimit.

Përfshirja për të cilën organizohet anketë publike dhe prezantim publik për Dokumentacionin lokal planor urbanistik për objekte me qëllim G4 - depo të pjesë nga PK 5815/1, pjesë nga PK 5816 dhe pjesë nga PK 5817/1, KK Kuçevishite, Komuna e Çuçer Sandevës gjendet në pjesën jugore të KK Kuçevishite dhe në mënyrë administrative i takon Komunës së Çuçer Sandevës, madhësia e përfshirjes është 0,2010 ha.

Dokumentet planore do të ekspozohen në hapësirat e Komunës së Çuçer Sandevës në f. Kuçevishite. Qytetarët dhe subjektet juridike të interesuar në afatin e paraparë mund të parashtrorjnë vërejtjet, mendimet dhe propozimet e tyre përmes postës ose përmes arkivit të komunës, çdo ditë pune prej ora 09:00 deri në ora 15:00.

KOMUNA E ÇUÇER SANDEVËS  
KRYETARI I KOMUNËS  
Jovan Pejkovski

KOMUNA ÇUÇER - SANDEVË

Kryetari i Komunës së Çuçer - Sandevë

Në bazë të nenit 46 paragrafi 9 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16, 163/16, 64/18 dhe 168/18), Kryetari i Komunës së Çuçer Sandevës, publikon

LAJMËRIM

Informohen qytetarët dhe subjektet juridike nga Komuna e Çuçer Sandevës se Kryetari i Komunës së Çuçer Sandevës ka sjellë vendim për organizim të:

1. Prezantimit publik dhe anketës publike në lidhje me Dokumentacionin lokal planor urbanistik për ndërtim të objektit për qëllim G4 - depo të PK 3149, KK Gluvo Brazda, Komuna e Çuçer Sandevës.
2. Prezantimi publik i DLPU do të mbahet më datë 27.03.2019 (e mërkurë) me fillim në ora 11:00, në sallën e madhe të Komunës së Çuçer Sandevës
3. Anketa publike për DLPU do të zgjasë 5 ditë pune nga dita e publikimit në mjetet e informimit.

Përfshirja për të cilën organizohet anketë publike dhe prezantim publik për Dokumentacionin lokal planor urbanistik për ndërtim të objektit për qëllim G4 - depo të PK 3149, KK Gluvo Brazda, Komuna e Çuçer Sandevës, gjendet në pjesën jugore të KK Gluvo Brazda dhe në mënyrë administrative i takon Komunës së Çuçer Sandevës, madhësia e përfshirjes është 0,8185 ha.

Dokumentet planore do të ekspozohen në hapësirat e Komunës së Çuçer Sandevës në f. Kuçevishite. Qytetarët dhe subjektet juridike të interesuar në afatin e paraparë mund të parashtrorjnë vërejtjet, mendimet dhe propozimet e tyre përmes postës ose përmes arkivit të komunës, çdo ditë pune prej ora 09:00 deri në ora 15:00.

KOMUNA E ÇUÇER SANDEVËS  
KRYETARI I KOMUNËS  
Jovan Pejkovski

**Koha**  
http://www.koha.mk

**Koha**  
www.koha.mk  
koha@koha.com.mk | marketing@koha.com.mk  
Tel: 02 3179 - 904; Fax: 02 3118 - 000  
Adresa i kontakt dhe redaksion: Bul. Sasa Doleva n.11, | Q.T. Rrmuzija 10110 - prilep, 5100





## Pranga ish-futbollisti kolumbian, pjesë e "Clan del Golfo"

Ish-futbollisti i përfaqësueses kolumbiane, John Viafara është arrestuar nga policia me akuzën e trafikut të drogës, e mund të ekstradohet në SHBA sipas lajmeve të konfirmuara nga Prokuroria. Tashmë në moshën 40-vjeçare, ish-mesfushori ishte një prej 5 personave të vënë në pranga ditën e martë në Jamudi e Medellín, në veriperëndim të vendit, në një operacion të përbashkët mes zyrës së prokurorisë dhe policisë gjyqësore. Hetimet u drejtuan nga autoritetet amerikane dhe mësohet se të arrestuarit ishin pjesë e një rrjeti ndërkombëtar të trafikut të drogës, që kishte lidhje me strukturat kriminale të kartelit të drogës "Clan del Golfo". Viafara dyshohet se ka trafikuar kokainë me motoskaft dhe gjysmëndetëse nga Kolumbia në drejtim të Shteteve të Bashkuara, nëpërmjet Amerikës Qendrore, në periudhën 2008-2018. Në grup, ai njihej si "Futbollisti" dhe kishte për detyrë që të paguante transportuesit e të vendoste kontakte për dërgimin e ngarkesave të drogës në Amerikën Qendrore. Policia bëri të ditur se në vitet 2017 e 2018 sekuestroi 2.5 tonë kokainë nga grupi i Viafaras, me vlerë prej 28 milionë dollarësh. Viafara nuk është futbollisti i parë kolumbian që arrestohet për trafik droge. Në shkurt, ish-mbrojtësi Osorio u dënua me 5 vite "arrest shtëpie", pasi tentoi të trafikonte një kg kokainë në Spanjë, ndërsa vitin e kaluar, Freddy Rincon, që ka luajtur për Napolin e Realin e Madridit, u dënua për trafik droge dhe pastrim parash në Panama. Kolumbia është vendi prodhues më i madh i kokainës në botë, pjesa më e madhe e së cilës është e destinuar për tregun amerikan.

NBA

## WARRIORS "SHËTITIN" NDAJ PACERS

Golden State Warriors nuk ndalet, duke marrë fitoren e radhës dhe vijuar rrugën e mbrojtjes së titullit të kampionit. "Luftëtarët" i kënaqën mbështetësit e vet në "Oracle Arena", ku mposhtën Indiana Pacers. Rezultati përfundimtar ishte 112:89

Përballja më e rëndësishme e mbrëmjes në NBA ishte ajo mes Golden State Warriors dhe Indiana Pacers, por skuadra e drejtuar nga Steve Kerr nuk hasi ndonjë rezistencë të fortë, duke iu imponuar me rezultatin e thellë 112-89 ekipit nga Indianapolisi. Miqtë mundën të qëndronin në lojë vetëm në periudhën e parë, që u mbyll në barseshë 19-19, më pas sfida nuk pati më histori: Warriors morën epërsinë për ta mbyllur takimin pa shumë sforco me 23 pikë diferencë. DeMarcus Cousins me 19 pikë e 11 "rebound" dhe Klay Thompson me 18 pikë rezultuan më të mirët mbi parket për kampionët në fuqi të NBA. Fitore e vështirë për Denver



Nuggets në fushën e Washington Wizards me rezultatin 108-113. Skuadra e nga Colorado e mbylli me një epërsi pres 8 pikësh pjesën e parë, por në periudhën e tretë Wizards shkuan deri +10 pikë. Gjithsesi, në periudhën e fundit nisi shkëputja e Nuggets dhe me gjithë përpjekjet e Bradley Beal (25 pikë) e Thomas Bryant (22 pikë) vendësit nuk arritën ta shmangnin humbjen. Spikati loja në grup e Denverit, teksa 8 futbollistë miq arritën numër dyshifror pikësh. Detroit Piston fituan 98-118 në parketin e Phoenix Suns, ku zhvilluan një pjesë të dytë fantastike

falë lojës efikase Wayne Ellington (23 pikë) dhe Blake Griffin (17 pikë), pa harruar "double-double" e Andre Drummond, që e mbylli takimin me 16 pikë dhe 19 "Rebound". Plot 31 pikë realizoi lojtari më i mirë i takimit, Kemba Walker, në fitoren 113-106 të Charlotte Hornets ndaj Minnesota Timberwolves. Karl-Anthony Towns që shënoi 21 pikë dhe kontrollloi 16 topa si dhe Andrew Wiggins me 20 pikë nuk i mjaftuan ekipit të drejtuar nga Ryan Saunders për të shmangur humbjen e pestë radhazi që e largon edhe më shumë nga zona play off.


## Nga Premier League te burgu për pedofili, lirohet ish-ylli i Anglisë

Pas 3 vitesh burg, Adam Johnson është lënë i lirë. Ish-futbollisti i Manchester City e Sunderland, i akuzuar në 2016 për pedofili, është liruar nga burgu i Moorland, në Hatfield, pasi kreu 3 vite burg, nga 6 që ishte dënua. Mediat në Angli raportojnë se ish-futbollisti, tashmë 31 vjeç, do të jetë nën vëzhgimin e autoriteteve deri në vitin 2022 dhe gjatë kësaj periudhe nuk do të kryejë dot asnjë transaksion bankar me karta krediti dhe nuk do të lejohet ta takojë vajzën e vet, nëse nuk do të jetë e pranishme një punonjëse sociale. Po ashtu, Johnson nuk do të lejohet të ketë ndonjë kontakt me viktimën e tij, Ayla, e cila ishte minorene në kohën kur John-



son u arrestua. Ishte 2 mars 2015 kur Johnson, në atë kohë një ndëryjet e Sunderland-it në Premier League, u arrestua me akuzën e marrëdhënies seksuale me një minorene, 15-vjeçaren Ayla. Për momentin u lirua duke paguar dhe Sunderland-i e riktheu në ekip. Megjithatë, më 10 shkurt 2016 Johnson u shpall fajtor nga gjykata e Bradford për ngacmim të një minoreneje të njohur në internet, të cilët më pas e kishte takuar dhe puthur, por pa kryer seks sipas

tij. Më 24 mars erdhi dënimi: 6 vite burg, që më pas u ulën në 3. Gjatë qëndrimit në burg Johnson punoi si berber, por nuk iu nda as futbollit. Gjithsesi, tashmë me futbollin gjithçka ka marrë fund, të paktën në Angli, sepse asnjë klub nuk do pranojë ta regjistrojë. Mundësia e vetme është transferimi në ndonjë kampionat të dorës së dytë, aty ku mund të ketë shumë para dhe pak interes për reputacionin e futbollistëve.




## Lojtari nga Guineja që u bë yll në Gjermaninë Lindore

Në filmin "Pele aus Neubrandenburg" (Pele nga Neubrandenburg), emri Pele nuk i referohet yllit të futbollit nga Brazili, por Cherif Souleymanet, një atleti nga Guineja që pati një karrierë të suksesshme si futbollist në qytetin e Gjermanisë Lindore, Neubrandenburg, derisa po kryente shkollimin dyvjeçar si student socialist në vitet '60. Filmi i regjisori Benjamin Unger e Matthias Hufmann është pjesë e Festivalit Ndërkombëtar të Filmit të Futbollit, i hapur të enjten në Berlin. Ky festival është një dritare për futbollin nëpërmjet të cilit synojnë bashkimin e njerëzve me kultura të ndryshme. Niveli i Souleymanes si sulmues ndihmoi ngritjen e ekipit nga qyteti i vogël në divizionin e parë. Megjithatë, pasi ekipi u promovua në divizionin e parë, u përball me një befasi të keqe: një rregullorë e Gjermanisë Lindore ndalonte të huajt që të luanin në këtë divizion, shkruan DW. Në vitin 1962, ai u detyrua të kthehet në Guine, ku karriera e tij si futbollist lulëzoi. Souleymane luajti për Guinenë në Lojërat Olimpike të vitit 1968 që u mbajtën në Meksikë, kurse në vitin 1972 u shpall futbollisti më i mirë i vitit në Afrikë. Sot, derisa ai ecën rrugëve në vendlindjen e tij, është i rrethuar nga të rinjtë që e adhurjnë. Edhe pse nuk është një Pele, Souleymane pa dyshim se është një "VIP" i futbollit të Guinesë. "Kur isha në Gjermani, fëmijët më prekjin për të parë nëse kisha thëngjill në lëkurën time. Të gjithë ishin kureshtarë se për çfarë arsye kisha ardhur në Gjermaninë Lindore", kujton Souleymane. Gjatë qëndrimit të tij në këtë vend, Souleymane është përballur edhe me përvoja të tjera të pakëndshme. Prindërit e të dashurës së tij gjermane ia refuzuan propozimin për martesë, derisa në çdo ndeshje ai fyhej në baza raciste nga tifozët dhe lojtarët e ekipit kundërshtar. "Nuk ka qenë aspak lehtë për mua, pikërisht për shkak të ngjyrës së lëkurës. Por, unë isha i vendosur për t'iu treguar të gjithëve se jam një qenieje njerëzore dhe meritoj të respektohem sikurse të tjerët me ngjyrë të bardhë", thotë Souleymane.

## Vuajtjet dhe sakrificat për të realizuar ëndrrën sportive

Kur bora të shkrijë, kur fushat të bëhen të gjelbra duke lënë mbetjet e dimrit pas, Harry Laidlaw do të largohet nga Evropa dhe do të kthehet në Australi. Laidlaw 23-vjeçar ëndërron të bëhet si pjesa tjetër e skitarëve elitare, duke ndjekur borën gjatë gjithë vitit, shkruan CNN. Mirëpo vështirësitë financiare nënkuptojnë se pasi ka kaluar shtatë muajt e fundit nëpër malet kolosale, skitari alpin duhet të kthehet në shtëpi, të jetojë me prindërit dhe të punojë në ndërtimtar. Synimi i tij i vetëm është të fitojë mjaftueshëm para në mënyrë që të marrë skitë

dhe të lëshohet poshtë shpateve kur dimri të kthehet në majat e Evropës dhe ndoshta të bëhet një prej eksporteve më të mira të skijimit të vendit të tij. Ndonëse paraja nuk e motivon Laidlawin, ai e di se nuk do të përparojë në sport pa to. Australiani nuk është në mesin e skitarëve më të mirë alpin dhe nuk vjen as nga një vend ku ka resurse pa kufi për të financuar ambicjet e tij, që nënkupton se arritja në majë nuk është vetëm pyetje e talentit, por edhe e kushteve ekonomike. Mund të jetë shumë e vështirë, ngjashëm si të ngjitesh në majën më të lartë në



botë, Everest, me shoshone. Pak bëhen të mëdhenj pa financa dhe edhe më pak duan të financojnë ata që nuk janë të mëdhenj.

# SPALLETTI-ICARDI, MARRËDHËNIA MES TYRE ËSHTË AKOMA E ACARTË

Spalletti e ka informuar Icardin se nuk do të stërvitet me disa shokë, të mbetur në "Pinetina" gjatë pushimit ndërkombëtar, por veçmas. Me pak fjalë, nuk ka patur sqarim mes të dyve


Mauro Icardi është përsëri në dispozicion të Luciano Spalletti, por ajo që u pa dje në "Appiano Gentile", gjatë trajnimit të Interit, ishte më shumë ajër armëpushimi sesa paqe reale. Sipas "Tuttosport", në fakt, qasja e trajnerit ndaj ish-kapitenit ishte aq e ftohtë, sa që pas një shtrëngimi të shpejtë të duarve, Spalletti e informoi Icardin se nuk do të stërvitej me disa shokë, të mbetur në "Pinetina" gjatë pushimit ndërkombëtar, por veçmas. Me pak fjalë, nuk pati sqarim mes të



dyve. Ishte me të vërtetë e vështirë të imagjinohej një rikthim i menjëhershëm i argjentinasi, i cili, në fakt, nuk ka qenë në trajnim me skuadrën prej më shumë se një muaji dhe duhet të vazhdojë të punojë veçmas tërë javën. Kjo është arsyeja pse, deri më sot, grumbullimi i tij për ndeshjen ndaj Lazios nuk është i qartë, edhe pse sipas "La Gazzetta dello Sport", Icardi mund të gjejë të paktën një vend në stol. Ish-kapiteni "u ngroh


në palestër, së bashku me shokët e tij (ndër të tjerë, Handanoviç, Nainggolan, Dalbert dhe Ranocchia), pastaj e vazhdoi seancën në një fushë të veçantë, i mbikëqyruar nga trajnerët. Sulmuesi, me pak fjalë, do të duhet të punojë shumë për të rifituar vendin e tij në ekip dhe besimin e Spalletti. Trajneri zikaltër, javët e fundit ka "vënë bast" për Lautaro Martinez dhe nuk duket i gatshëm të kthehet mbas kaq lehtë. Sidoqoftë, qëlli-

mi i Interit është ta llogarisë Icardin të paktën deri në fund të sezonit dhe në këtë kuptim prania e tij e plotë në "Appiano" duhet të mos diskutohet. Icardi, nga ana tjetër, përfaqëson një aset ekonomik dhe teknik. Kjo është arsyeja pse një pushim nuk do të kishte qenë i dobishëm për asnjërin, madje as për shkak të një "divorci" gjithnjë e më të mundshëm. Çmimi minimal i argjentinasi është 80 milionë euro.



## Higuain i ngelet në derë Juventusit

Gonzalo Higuain mund të kthehet në Torino, lajmin e publikon e përditshmja angleze Mirror, ku arsyetohet detajet e një rikthimi të bujshëm të El Pipitas në kampin juventin. Sipas tabloidit shumë shpejt Chelsea mund të dalë me vendimin për të rikthyer sulmuesin argjentinasi në Serinë A italiane duke mos e zgjatur huazimin e tij edhe për 12 muaj të tjerë apo akoma më tej blerjen e tij. Performanca e Gonzalos mesa duket nuk ka bindur deri më tani drejtuesit e klubit anglez, por me bllokimin e merkatos së bluve të Londrës shanset e Higuain për të qëndruar në Londër duken ende të hapura. Juve, Milan, Chelsea dhe sërish Juve ka qenë aksi i argjentinasi kohët e fundit dhe pas largimit nga klubi torinez kjo verë duket se projekton sërish përshkrimin e rrugës drejt zonjës së vjetër për bomberin e zbehur, një rikthim që nëse ndodh mendohet të jetë i përkohshëm. Të gjitha të dhënat flasin se Higuain nuk bën më pjesë në projektin e bardhezinjve ndaj me ripërfshirjen hipotetike të tij në organikën e Joves në qershor, Paratici mund të vihet në kërkim të një tjetër klubi që shfaq interes për të, për të mënjauar kësh-tu edhe një situatë të sikletshme. Me vetëm tre gola që nga mbërritja e tij në Stamford Bridge, shumë shpejt Higuain mund të cilësohet si i papëlqyer nga klubi i Premier Leagues që nuk ka më interes për të blerjen apo zgjatjen e huazimit të tij. Sidoqoftë me Giroud dhe Hazard që projektohen drejt largimit në fund të këtij sezoni, Blutë e Londrës mund të ndryshojnë mendim për të evituar mundësinë e mbetjes pa sulmues. Në këtë kontekst e ardhmja e Higuain është më shumë se kurrë në duart e Chelseat.



## Bayerni siguron Hernandezin

Mbrojtësi i Atletico Madridit, Lucas Hernandez, ka arritur marrëveshje me Bayern Muenchenin, pasi ekipi gjerman i ka ofruar kontratë pesëvjeçare. Gazeta "AS" të enjten ka raportuar se Hernandez në fund të këtij edicioni do t'i bashkohet Bayernit, që për kartonin e tij do t'i paguajë Atletico Madridit 80 milionë euro dëmshpërblim. 23-vjeçari, te Bayerni shihet si përforcim i rëndësishëm dhe gjithçka do të bëhet zyrtare para përfundimit të këtij edicioni. Hernandez është pjesë e ekipit të parë të Atletico prej vitit 2015 dhe deri më tash ka mbi 100 paraqitje. Ai këtë edicion ka shënuar një gol në 22 ndeshje, kurse me Atletico ka kontratë deri në vitin 2024. Hernandez ka edhe 15 paraqitje me Përfaqësuesen e Francës, me të cilën vitin e shkuar fitoi titullin e botës.

## Bale: Ronaldo i mrekullueshëm

Gareth Bale ka hedhur poshtë aludimet mediatike se marrëdhëniet e tij me Cristiano Ronaldo te Real Madridi kanë qenë të tensionuara. Në një intervistë për BT Sport, uellsiani nënvizon: "Cristiano është një lojtar i jashtëzakonshëm, kam qenë i lumtur duke luajtur me të. Natyrisht, media përpiqet të bëjë lajm edhe aty ku nuk ka dhe shkruante për probleme që nuk ekzistojnë. Kemi kaluar shumë mirë së bashku. Ai është ende një lojtar i jashtëzakonshëm". Pavarësisht nga këto deklarata, e vërteta është se përfaqësuesit e yllit të Uellsit pranuan më herët se marrëdhëniet e tyre ishin të ftohtë. Madje, agjenti i tij, Jonathan Barnett, e sulmoi diku Cristiano Ronaldo për të mbrojtur klientin e vet: "Ata janë krejtësisht të ndryshëm, por mes tyre nuk ka urrejtje. Nuk dalin bashkë për darkë çdo



natë, por çdo gjë është e mirë. Unë nuk mendoj se Bale do të jetë modeli më i mirë i botës, që të shesë të brendshme". Gareth Bale ka komentuar edhe se si e përjetoi interesimin e Real Madridit, kur klubi i bardhë kërkoi nënshkrimin me të në verën e vitit 2013: "Më duhej të vlerësoja të gjitha ato që Tottenham kishte bërë për mua. Sidoqoftë, kur një klub si i madh si

Real Madridi interesohet për ty, është e vështirë për ta refuzuar". Lidhur me idhujt që kishte në fëmijërinë e tij, por tifozët e Tottenham nuk do të donin ta dëgjonin, për shkak të rivalitetit me Arsenalin, Bale përmendi emrat e dy "topçinjve", si Henry dhe Bergkamp. Megjithatë, referimi i tij i madh ishte Ryan Giggs, tani trajneri i Uellsit.



Qëndrueshmëri, udhëheqje dhe karizëm. Krzysztof Piatek nuk është prekur nga ndryshimi i ajrit, prej transferimit nga Genoa te Milani në janar, duke vazhduar të

## Shevchenko "pagëzon" trashëgimtarin e tij te Milani

bëjë atë që bën më mirë: të shënojë gola. Polaku është aktualisht i dyti në klasifikimin e golashënuesve të Serie A (19 gola), në të njëjtën "gjatësi vale" me Cristiano Ronaldo dhe vetëm pas Quagliarella. Në derbin e fundit ai mbeti thatë, por kjo nuk e eklispon aspak atë që ka bërë deri më tani me fanellën kuqezi. Sulmuesi i datëlindjes 1995 mori vlerësime edhe

nga Andriy Shevchenko, trajneri aktual i kombëtares së Ukrainës dhe "flamur" i kuqezinjve, falë 175 golave të shënuar për ta. I intervistuar nga "Sportmediaset", Sheva pati fjalë të qarta dhe konçize për Piatek: "Po (në lidhje me pyetjen, nëse ai mund të jetë trashëgimtar i tij), ai ka një stil të pabesueshëm për golin. Po tregon se është një sulmues i madh, po e ndihmon

Milanin kaq shumë". Interi e fitoi derbin e fundit të Milanos, duke përsëritur suksesin e ndeshjes së parë. Shevchenko thotë fjalën e tij: "Unë e pashë derbin. Në minutat e fundit, Milani kishte disa shanse dhe mund ta mbyllte mirë. Mendoj se ende i ka mundësitë për t'u renditur në vendin e duhur, që e dërgon në Ligën e Kampionëve. Jam optimist se do ta bëjë këtë".






# SPANJOLLËT DUAN TA KLONOJNË MESSIN!

Etiketimet për lojtarin që konsiderohet më i miri i historisë kanë mbaruar. Është e vështirë të gesh një fjalë “të madhe” që nuk është përdorur për të përshkruar “bëmat” e “yllit” të Barcelonës. Ekziston frika se bota e futbollit nuk do të shohë më një Messi të dytë kur “Pleshti” të varë këpucët në gozhdë. Atëherë cila është zgjidhja për të mos e “humbur” Messin? Edhe pse mund të duket surreale, na e tregon me një pyetje “Cadena Ser”: “A mund të klonohet Messi?”

Për ta zgjidhur këtë çështje, kjo media spanjolle ka kontaktuar Arcadi Navarro, specialist i gjenetikës dhe



përgjegjës i Arkivit Europian të Gjenetikës, i cili jep këtë përgjigje: “Po, Messi

mund të klonohet me teknikat e kohës. Do të ishte e mundur të përftonim një qenie njerëzore shumë të ngjashme me Messin, një binjak. Do të ishte sikur kanë lindur në të njëjtën kohë, por njëri prej tyre ka mbetur i ngriçur për 20-30 vjet. A do të trashëgonte Messi i Ri talentin gjenetik të sulmuesit aktual “blaugrana”?

“Ky person mund të ketë të njëjtin potencial të Messit, cilësitë e tij dhe përbërësit gjenetike, por duhet theksuar se Messi është Messi jo vetëm për shkak të përbërësve gjenetike, por edhe për mënyrën e tij të jetesës, edukimit të tij dhe faktorët e jashtëm që kanë influencuar te formimi i tij”.



## Një pornostare për kryebashkiake

Çdo person ka të drejtë të ndryshojë jetën e tij, duke lënë pas të shkuarën. Një rast i tillë është për Elena Berkova. 34-vjeçarja do të kandidojë për kryetare të qytetit të saj, në Rusi, duke lënë pas punën si pornostare. Diçka e pabesueshme, por e vërtetë. Aktorja e filmave për të rritur ka njoftuar se po planifikon të marrë pjesë në zgjedhjet në qytetin në rajonin Murmansk, të pjesës veriore të Rusisë.

Me një foto në Instagram, Elena ka kërkuar nga ndjekësit e saj, që t'i tregojë se me çfarë problemesh po hasin. “Çfarë probleme keni ju në qytet? Si janë gjërat në infirmieri, shkolla, shtëpi apo spitale? Dua që të di çdo gjë rreth Murmanskit! Unë jam me ju” shkruan ajo në rrjetet sociale. Në një intervistë për radion lokale, 34-vjeçarja madje premtoi se me programin e saj politik, çdo person do të gjejë zgjidhje për problemet që kanë, sigurisht e gjitha kjo nëse merr votat e tyre.

Shumë persona kanë qenë skeptik, por kjo nuk është hera e parë që Berkova kandidon për kryetare qyteti. Në vitin 2009, ajo njoftoi se do të garojë për kryetare në qytetin Sochi dhe madje lëshoi edhe një video fushate, por kurrë nuk u regjistrua si kandidat.

## Ish-presidenti bëhet “tap”, arrestohet i dehur në publik

Ish-presidenti i Perusë, Alejandro Toledo është arrestuar në Kaliforni, pasi akuzohet për deheje në publik. Ish-kreu i shtetit, i cili është i kërkuar nga autoritetet peruane nën akuzën për korrupsion, u arrestua të mërkurën në mbrëmje në një restorant në San Mateo, në jug të San Franciskos. “Ai u lirua nga burgju i qytetit të Redwood të hënën në mëngjes në përputhje me procedurat ligjore të atij vendi, pasi shkelja nuk meritonte një burgim më

të gjatë”, tha Ministria peruane e Punëve të Jashtme. Toledo u zhvendos në Shtetet e Bashkuara të Amerikës pasi u akuzua në atdheun e tij se kishte marrë 20 milionë dollarë ryshfet nga kompania braziliane “Odebrecht” gjatë qëndrimit të tij në pushtet (2001-06). Por, ai i mohon këto akuzat. Ministria e Punëve të Jashtme të Perusë tha gjithashtu se arrestimi nuk kishte asnjë lidhje me procedurat për ekstradim.



## I injektoi vetes lëng frutash, për pak sa nuk vdiq



Një grua në Kinë pothuajse sa nuk vdiq pasi i injektoi vetes një koktej me 20 lloje lëngje frutash. Në një përpjekje për të përmirësuar shëndetin e saj, 51-vjeçarja nga Guiyang County në Chenzhou, provinca Hunan, e injektoi lëngun në vena. Pas injektimit me përzierje, pacientes iu irritua lëkura dhe pati temperaturë të

lartë. “Gruaja, e cila ishte e interesuar për trajtimet e pazakonta shëndetësore, pësoi dëmtime të mëlçisë, veshkave, zemrës dhe mushkërive dhe u fut në kujdes intensiv për pesë ditë”, sipas një raporti nga e përditshmja kineze Xiaoxiang Morning Herald. “Unë mendova se frutat e freskëta ishin shumë ushqyese dhe nuk do të më bënin dëm duke i injektuar ato në trupin tim. Nuk e kisha idenë që do të më shkaktonin një telash të tillë”, tha ajo.

Mjekët në Spitalin Affiliated të Universitetit Xiangnan në Hunan ia hoqën toksina nga gjaku duke përdorur dializë dhe i dhanë antibiotikë.

Pas pesë ditësh gjendja e saj u përmirësua dhe u transferua nga kujdesi intensiv në pavijonin e veshkave. Ata thanë se pacientja për pak sa nuk humbi jetën sepse shumë organe jetësore i dolën jashtë funksionit.

1026 - Koenraad II shpall veten mbret të Italisë.

1657 - Franca dhe Anglia formojnë aleancë kundër Spanjës.

1808 - Vëllai i Napoleonit, Jozefi merr fronin e Spanjës.

1821 - Beteja dhe rënia e qytetit të Kallamatës. Lufta për pavarësinë e Greqisë.

1918 - Lituania shpall pavarësinë.

1919 - Benito Mussolini formon Lëvizjen fashiste në Milano të Italisë.

1929 - Instalohet telefoni i parë në Shtëpinë e Bardhë.

1936 - Italia, Austria dhe Hungaria nënshkruajnë Paktin e Romës.

1950 - Themelohet Organizata Botërore Meteorologjike pranë OKB.

1956 - Sudani shpall pavarësinë.


2001 - Stacioni rus në gjithësi MIR hiqet nga përdorimi dhe shkatërron në atmosferë para se të bije në pjesën jugore të Oqeanit Paqësor afër Fixhit.

KALENDARI HISTORIK 23 MARS

Adhuresit e çokolatës janë më pak të stresuar se të tjerët. Një studim në SHBA thotë se ata janë shumë më pak shanse të vuajnë nga depresioni.



I vetmi majmun që është dënuar nga një gjykatë e vërtetë është shimpanzeja Coco në Florida, në vitin 1984. Ky majmun jetonte me një artist të papunë, i cili jepte spektakle të vogla. Shuma e vjedhur arrinte vlera 200.000 USD. Ai u dënua me burgim të përjetshëm.



Njerëzit që japin këshillat më të mira, zakonisht janë ata që kanë më së shumti probleme.



### IPHONE

- A po të pëlqen iPhone im i ri?
- Po, sa e ke blerë?
- Nuk e kam blerë, e fitova në gara në vrapim.
- Sa mirë, sa persona morët pjesë?
- Tre ishimi, polici, pronari i telefonit dhe unë.

A E DINI SE...

BARSOLETA

THËNIA E DITËS



S'duhet të luftoni shumë shpesh me një armik, përndryshe do t'ju mësojë të gjitha marifetet e luftës. (Napoleon Bonaparta)